



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“OPERATORIN E SISTEMIT TE TRANSMETIMIT SH.A.”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI PËRPUTHSHMËRINË & RREGULLSHMËRINË
NË
“OPERATORIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SH.A.”

Korrik 2023

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	2-9
1.	Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit	2
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	2
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8
II.	HYRJJA	9-12
1.	Titulli.....	9
2.	Marrësi.....	10
3.	Objektivat dhe qëllimi.....	10
4.	Identifikimi i çështjes.....	10
5.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	10
6.	Përgjegjësitë e audituesve.....	10
7.	Kriteret e vlerësimit.....	11
8.	Standardet e auditimit.....	11
9.	Metoda e auditimit.....	12
10.	Dokumentimi i auditimit.....	12
III.	PËRSHRIMI I AUDITIMIT.....	12
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	12
2.	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit.....	12
2.1	Pika 1 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së	12
2.2	Pika 2 “Auditim me zgjedhje në disa Njësi Operative të Transmetimit	16
2.3	Pika 3 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori) dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra	17
2.4	Pika 4 Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve	19
2.5	Pika 5 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve	26
2.6	Pika 6 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave	30
2.7	Pika 7 Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.)	48
2.8	Pika 8 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar	55
2.9	Pika 9 Mbi hartimin, shqyrtimin, zbatimin dhe raportimin e programit ekonomiko-financiar	58
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	67
	Masa Organizative	67
	Masa Shpërblim Dëmi	73
	Masa për Eliminimin e Efekteve Negative	74
V.	Lista e dokumentacionit të auditimit.....	74
VI	ANEKSE.....	

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së nr.222/1 Prot., datë 16.03.2023, për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022 si dhe zhvillimin e auditimit “Mbi Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë” nga data 16.03.2023 deri më datë 19.05.2023 në subjektin Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.. (Këtu e tutje OST sh.a.).

Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje	Ref.	Rëndësia	Rekomandimi
1	Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Operatorin e Sistemit të Transmetimit administruar në KLSH me nr. 1188/6 prot., datë 07.08.2019, janë rekomanduar gjithsej: - 27 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 8 masa, , në proces zbatimi 18 masa dhe të pa zbatuara 1 masë. 5 masa shpërblim dëmi, nga të cilat janë zbatuar 4 masa, , në proces zbatimi 3 masa në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “j”.	2.1	E Mesme	OST sh.a. të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, me synim realizimin e objektivave dhe në përbushjen e misionit të shoqërisë.
2	Gjatë auditimit të pikës 4 të Programit të Auditimit “Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve”, në lidhje me rekrutimin e punonjësve të rinj, në asnjë rast nuk u evidentua ndonjë gjurmë që sektorëve/departamenteve përkatëse ju ka lindur nevoja për rekrutimin e punonjësve të rinj në mospërputhje me Manualin e Burimeve njerëzore nr. 7862 Prot., datë 27.12.2016, i ndryshuar.	2.4	E Mesme	OST sh.a., gjatë hartimit të strukturës organizative të aparatit qendror OST sh.a. dhe njësive të vartësisë, dhe në momentin e plotësimit të strukturës me punonjës të rinj, të marrë në konsideratë nevojat e sektorëve/departamenteve dhe njësive të vartësisë që të arrijnë eficiencën e plotë me qasjen me burimet njerëzore të duhura sipas nevojave
3	Gjatë auditimit të mënyrës së rekrutimi të punonjësve të rinj, nuk u dokumentua një procedurë e mirëfilltë e rekrutimit të tyre. Deri në përzgjedhjen e tyre nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura; nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar hapat që ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj në mospërputhje me Manualin e Burimeve njerëzore nr. 7862 Prot., datë 27.12.2016, i ndryshuar.	2.4	E Lartë	OST sh.a., gjatë rekrutimit të punonjësve të rinj, të kryejë procedurat sipas metodave më të mira dhe me të drejta, për zhvillimin e tyre me transparencë të plotë dhe konkurrencë të plotë, duke përzgjedhur kandidatin e duhur sipas nevojave të institucionit.

4	Gjatë auditimit të dosjeve të personelit dhe të dokumentit mbi “Detyrat funksionale dhe Kriteret e punësimit për pozicionet e punës”, përzgjedhja e punonjësve nuk është bërë në çdo rast në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj; në mospërputhje me Manualin e Burimeve njerëzore nr. 7862 Prot., datë 27.12.2016, i ndryshuar.	2.4	E Lartë	OST sh.a., gjatë rekrutimit të punonjësve të rinj, të marrë në konsideratë të gjithë kriteret e vendosura dhe të miratuara nga Këshillimi Mbikëqyrës si dhe në Manualin e Burimeve Njerëzore
5	Gjatë auditimit të Pasqyrave Financiare, në vlerësimin e aseteve, vihet re që OST sh.a. nuk i ka regjistruar të gjitha pronat në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Ndërtimet në proces përfaqësojnë ndërtimin e aktiveve të transmetimit, duke përfshirë kryesisht linja transmetimi dhe nënstacione në mospërputhje me SNK 16 Aktivet Afatgjata Materiale. Njohja e aktiveve afatgjata materiale behet me vlerën e drejte ne mënyrë periodike çdo 5 vjet.	2.5	E Mesme	OST, të bëjë të mundur ndjekjen dhe finalizimin e të gjitha procedurave në lidhje me regjistrimin e pronave në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.
6	Gjatë auditimit të pasqyrave financiare vihet re që në zërin Hua për palët e treta që lidhet me huan e dhënë për Albgaz sh.a me vendimin nr. 22, datë 13 qershor 2017, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a. Afati i maturimit të kredisë është dy vite. Sipas marrëveshjes mes OST dhe Albgaz Sh.a. huamarrësi ka për detyre kthimin e shumës së plotë të huas me norme interesi 0 (zero) tek huadhënësi brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshje. Me date 22/10/2019 është firmos Amendimi Nr.1 i marrëveshjes së mësipërme sipas të cilit Huamarrësi ka për detyrim kthimin e shumës së plotë të huas tek Huadhënësi me norme interesi zero brenda tre viteve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes si dhe dy amendimeve të tjera, në mospërputhje me Vendimi nr. 22, datë 13 qershor 2017, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a	2.5	E Lartë	OST sh.a., të marrë të gjitha masat mbi kthimin e shumës së plotë të huas nga Albgaz sh.a., duke iu përmbajtur kushteve të kontratës, dhe në rast të moskthimit të shumës nga ana e tyre të marrë masat mbi vendosjen e kamatëvonesave ose penalizimeve sipas kushteve të kontratës.
7	Gjatë auditimit të pasqyrave financiare vihet re një rritje në riskun mbi likuiditetin që përcaktohet si risku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. OST është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndodhura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer kreditë. Nga ana tjetër, shoqëria përballet me vonesa të konsiderueshme në arkëtimet e shitjeve që i ka bërë OSHEE Sh.a. për shërbimin e transmetimit të energjisë.	2.5	E Lartë	OST sh.a., të marrë të gjitha masat mbi arkëtimin e shitjeve që i ka bërë OSHEE sh.a. për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike si dhe në rast të vonesave mbi arkëtimin e tyre të marrë masat mbi vendosjen e kamatëvonesave duke iu përmbajtur kushteve të kontratës.
8	Gjatë analizimi të procedurës së prokurimit me objekt “Rinovimi i suportit dhe licensave të platformës elektronike financiare, burimeve njerëzore, arshive elektronike dhe sistemit të menaxhimit të dokumenteve”, gjatë verifikimi të	2.5	E Lartë	OST, në rastin e vlerësimit të ofertave të kryhet vlerësim i drejtë dhe transparent duke u bazuar

	<p>dokumentacioni të ngarkuar në sistem nga ana e O.E. fitues, në lidhje me pikën 2.3.3 në Kriteret e Vecanta “<i>Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë suportin ose autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij</i>”, O.E. fitues ka paraqitur deklaratë nga Zyra e përfaqësisë Oracle në Shqipëri, Oracle N... B.V. Albania Representative Office. Nga hulumtimet e kryera nga grupi i auditimit në faqen zyrtare të kompanisë Oracle, O.E. nuk rezulton të jetë partner i kompanisë Oracle, ashtu siç deklaroi.</p> <p><i>Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë certifikimet si më poshtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> · <i>sisteme Oracle ERP;</i> · <i>sisteme BI;</i> · <i>infrastructure Cloud;</i> · <i>sisteme ERP Cloud;</i> · <i>sisteme për rrjetin e shpërndarjes (Supply Chain);</i> · <i>Certifikata e lëshuar nga Tatimet dhe AKSHI si prodhues dhe për mirëmbajtjen e softuerike për fiskalizimin me dhe pa para në dore, faturën elektronike si dhe faturën shoqëruese (qe ofertohet).</i> <p>Periudha e vlefshmërisë së certifikimeve të mësipërme është deri më 29 Mars 2023, periudhë që nuk e mbulon të plotë shërbimin 1 vjeçare të Rinovimit të suportit dhe licencave në mospërputhje me Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.</p>		<p>në bazën ligjore dhe udhëzimet përkatëse si dhe duke i dhënë gjithmonë përparësi ofertave më të ulëta në rast se përmbushin dokumentacionin e plotë të kërkuar dhe në rastin kur oferta është e dyshimtë mbi përmbushjen e disa kriterëve ose specifikimeve, të kërkohej informacion më tepër në lidhje me të, deri në sqarim e plotë të rastit.</p>
9	<p>Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt “Shërbimi privat i sigurisë fizike”, në vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit ngarkuar në sistem nga O.E. fitues të procedurës u konstatua që në dokumentacionin e sjellë nuk citohet se cilët do jenë punonjësit me të cilët do të realizohet shërbimi, por janë mjaftuar me certifikatat për punonjës shërbimi, ku për të cilët janë sjellë në tërësi të gjitha certifikatat e lëshuara për të gjithë punonjësit e O.E..</p> <p>Lista e punonjësve do të bënte të mundur dhe verifikimin nëse këto punonjës nuk janë angazhuar në kontrata të tjera të lidhura nga O.E. Gjithashtu nuk është kërkuar një listëpagesë e punonjësve e shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe një deklaratë bankare, pasi nga O.E. deklarohet që pagesa për punonjësit është në vlerën 66,359.88 lekë/roje/muaj. Për sa më sipër në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.</p>	2.6	E Lartë OST sh.a., gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të marrë në konsideratë të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të detajuara të nevojshme si dhe gjatë vlerësimit të ofertave të bëjë testet dhe verifikimet përkatëse me çdo institucion tjetër në lidhje me deklaratat e lëshuara nga O.E. pjesëmarrës.

10	Gjatë analizimi të procedurës së prokurimit me objekt “Suport, licenca dhe mirëmbajtje për pajisjet Hardware”, në hartimin e kriterëve të vecanta janë përfshirë në kriterin 2.3.4 Përdorimi i termit në këtë rast certifikuar nga prodhuesi kufizojnë konkurrencën dhe nuk janë në përputhje me objektin e kontratës dhe vlerën e kontratës. Procedura e hapur e thjeshtuar nuk duhet të ketë shumë kriterë, në mënyrë që të jetë e mundur përfshirja e biznesit të vogël dhe të mesëm në kundërshtim me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.	2.6	E Lartë	OST sh.a., gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të mirëmbajtjes së pajisjeve hardëare, të krijojë kushte me gjithëpërfshirëse, pasi vendosja e kriterëve të cilët kërkojnë certifikime të prodhuesve pengojnë zhvillimin e një gare dhe konkurrence të drejtë.
11	Gjatë analizimi të procedurës së prokurimit me objekt “Suport, licenca dhe mirëmbajtje për pajisjet Hardëare”, në vlerësimin e ofertave vihet re që pika 2.3.3 e kriterëve të vecanta “ <i>Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë suportin ose autorizimin e prodhuesit/distributorit te autorizuar per pajisjet dhe platformat (Sëitche, NFGË, platforme NAC, sistemi NMS, Akses Point, Sëitche Akses).</i> Autorizimi duhet te përmbaje te dhëna te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij”, nuk përmbushet nga O.E. fitues, ku në dokumentet e ngarkuara nga O.E. në sistemin elektronik të APP, gjendej vetëm një autorizim nga Hewlet Packard me anë të emailit, ku dhe kjo e fundit nuk i mbulon të gjitha artikujt në specifikimet teknike në kundërshtim me Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.		E Lartë	OST sh.a., të tregojë kujdes gjatë vlerësimit të ofertave dhe të marrë në konsideratë të gjithë kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara nëse janë ose jo në përputhje me dokumentacionin e sjellë nga O.E. pjesëmarrës.
12	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “FV lexues aksesi dhe sisteme të tjera për zonat e sigurisë së lartë në AQ dhe njësi”, në analizimin e kriterëve të vecanta të kualifikimi vihet re kriteri nr. 2.3.5, sipas grupit të auditimit, duke u bazuar dhe tek vlera e kontratës, certifikimet e kërkuara janë të tepërta, pasi kufizojnë konkurrencën dhe nuk janë në përputhje me objektin e kontratës dhe vlerën e kontratës. Procedura e hapur e thjeshtuar nuk duhet të ketë shumë kriterë, në mënyrë që të jetë e mundur përfshirja e biznesit të vogël dhe të mesëm në kundërshtim me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.	2.6	E Lartë	OST sh.a., gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të mirëmbajtjes, të krijojë kushte me gjithëpërfshirëse, pasi vendosja e kriterëve të cilët kërkojnë certifikimin e vetëm të prodhuesve do të pengojnë zhvillimin e një konkurrence të drejtë.
13	Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, disa nga procedurat e prokurimit janë zhvilluar muajin e fundit të vitit, që përbëjnë risk mbi mënyrën e përdorimit të fondeve si dhe disa nga procedurat e tjera të cilat kanë objekt të ngjashëm me njëra tjetrën por që janë zhvilluar të ndara, duke bërë të mundur copëzimin e fondit dhe jo përdorimin e procedurave të prokurimit me vlerë të lartë.	2.7	E Mesme	AK të marrë masa për trajnimin e punonjësve që kryejnë procedurat e prokurimit, duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve të brendshme për menaxhimin

				e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomikitet.
14	<p>Bazuar në tabelën e mësipërme, në seksionin shënime, janë vënë në dukje të ardhurat dhe shpenzimet, mbi të cilat planifikimi i tyre nuk ka qene i saktë, dhe devijanca e tyre në lidhje me realizimin është e lartë.</p> <p>Shpenzimet janë rritur ndërkohë që të ardhurat janë pakësuar OST, ka programuar zëra shpenzimesh të cilët nuk i shërbejnë qëllimit dhe natyrës së aktivitetit të punës, mungon lidhja e objektivave dhe qëllimit të tyre me produktin konkret të projektit dhe programit buxhetor, si edhe një analizë e detajuar prioritarizmi duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara, duke cënuar kështu përdorimin me efencë, efektivitet dhe produktivitet të fondeve në dispozicion të institucionit, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> · Shpërblime për ndryshim strukture · Shpenzime për pagesë largimi nga puna · Shpenzime për dalje në pension <p>Shpenzimet për ekspertë kontabël dhe vlerësues, u realizuan në vlerën 44.1 milionë lekë nga 20 milionë lekë të parashikuara, duke kaluar fondit e parashikuar me gati 2 herë të parashikimit.</p>	2.9	E Lartë	OST sh.a., në të ardhmen, gjatë hartimit të buxheteve, të analizojë me kujdes situatën e shoqërisë, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e tyre, negocimin e kushteve më të mira si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive. Të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi si dhe të kryejë një planifikim të saktë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke u bazuar dhe në vitet e mëparshme.
15	Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit, u konstatua se nuk administrohet Oponenca Teknike e objekteve të ndërtimit “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë” dhe “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6.	2.6	E Lartë	Titullari i OST sh.a. të marrë masa që të gjitha objektet që prokurohen si “punë publike”, të pajisen me oponencën teknike para fillimit të procedurës së prokurimit, me qëllim që të jenë konform standardeve të projektimit, për të përfutur objekte cilësore.
16	Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit, u konstatua se kolaudimi i objekteve “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë” dhe “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”, është kryer nga stafi teknik i OST sh.a., të cilët nuk janë të pajisur me licencën profesionale për kolaudimin e objekteve, në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 12.	2.6	E Lartë	Titullari i OST sh.a. të marrë masa që për të gjitha objektet që zbatohen në OST, të ngrihen grupe kolaudimi me specialistë të licencuar profesionalisht, me qëllim kontrollin cilësor të punimeve të përfunduara. Në rast të mungesës së një stafi të licencuar në institucion, kolaudimi të kryhet nga shoqëri/individë me licencat përkatëse të kolaudimit.

17	<p>Nga auditimi i realizimit të punimeve në procedurën e prokurimit me objekt “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë”, u konstatua se:</p> <p>-Ka patur diferenca në volume në zërin e punës “Trajnim i inxhinierëve të SMR për parametrizimin dhe aksesimin e pajisjeve (sipas specifikimeve teknike)”, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p>	2.6	E Lartë	<p>Nga OST sh.a. të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 802,400 lekë pa tvsh nga OE “G...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 968/14 prot datë 11.05.2021 me objekt “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.</p>
18	<p>Nga auditimi i realizimit të punimeve në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”, u konstatua se:</p> <p>-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Gërmim dheu me ekskavator 0.25 m3, tokë e zakonshme, kategoria III, për rrugët, t=20cm, me shkarkim në mjet”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve</p>	2.6	E Lartë	<p>Nga OST sh.a. të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 237,600 lekë pa tvsh nga BOE “A & E” SHPK & “K...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1246 prot datë 27.04.2021 me objekt “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.</p>
19	<p>Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Automjete me qira operationale Leasing”, nga strukturat përgjegjëse të OST në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit, nuk është kryer një analizë kosto-përfitim në lidhje me automjetet e mësipërme, nëse do ishte menduar zhvillimi i procedurës për blerjen e tyre, duke analizuar përfitimin mbi përdorimin e tyre si dhe vlerën e mbetur pas 60 muajve (5 viteve), duke e cilësuar fondit prej 35,450,000 lekë si fond i përdorur pa 3E, në kundërshtim me Ligjin nr.10 296, Datë 8.7.2010 Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin.</p>	2.6	E Lartë	<p>OST sh.a., në të ardhmen, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të kryejë një analizë kosto përfitim të tyre mbështetur në praktikat më të mira.</p>

III. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a., në përgjithësi ka zbatuar kuadrin rregullator, por janë konstatuar edhe shmangie të cilat kanë ndikuar në performancën financiare të shoqërisë. Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit nuk përcaktohen qartë specifikimet teknike dhe kriteret e vecanta si dhe zbatimit dhe ndjekja e kontratës nuk kryhet si duhet nga grupet e marrjes në dorëzim dhe ndjekjes së kontratave.

Në hartimin e kërkesave buxhetore janë konstatuar se OST, ka programuar zëra shpenzimesh të cilët nuk i shërbejnë qëllimit dhe natyrës së aktivitetit të punës.

Opinion i Auditimit

I. Opinion për auditimin e përrputshmërisë:

Ne audituam përrputshmërinë e veprimtarisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të OST sh.a., gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përrputshmërisë.”

II. Baza për opinionin e përrputshmërinë.

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit “Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.” në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42.

Auditimi u krye në përrputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përrputshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet ISSAI-P1, “Deklarata e Limës”; ISSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI P-12, ISSAI P-20, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përrputshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përrputshmërisë”. Në i kemi përrmbushur përgjegjësitë tona etike, në përrputhje me standardet e sipërrpërmendura, përrfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga OST sh.a. dhe përgjegjësitë janë përrmbushur në pajtim me këto kërkesa. Në besojmë së dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përrshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Auditimi ynë përrfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përrzgjedhur mbështetur gjithashtu mbi gjykimin profesional të audituesit. Gjithashtu, në besojmë së dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përrshtatshme për të siguruar bazat për përrgatitjen e opinionit të auditimit.

Gjithashtu shoqëria ka përrdorur pa Ekonomicitet, Eficence dhe Efektivitet Fondet Publike në shumën **35,450,000** lekë pa TVSH.

Gjatë auditimit të zbatimit të kontratave në punimet e ndërtimit janë konstatuar veprime me dëm ekonomik me vlerë **1,040,000** lekë pa TVSH.

III. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i OST-së. është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi. Drejtimi është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e buxhetit dhe të pasqyrave të llogaridhënies vjetore në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm efektiv, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

IV. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë *siguri të arsyeshme*, që veprimtaria e OST-së., në të gjitha aspektet, është pa gabime dhe anomali materiale. Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), Objektivi ynë lidhet me *dhënien e sigurisë së arsyeshme* mbi përputhshmërinë e aktivitetit të OST-së, me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare e administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Për këtë audituesit e KLSH, aplikojnë gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese nëpërmjet të cilës, audituesit identifikojnë çështjet më të rëndësishme që trajtohen në Projekt Raportin e auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së nr.222/1 Prot., datë 16.03.2023, për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022 si dhe zhvillimin e auditimit “Mbi Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë” nga data 16.03.2023 deri më datë 19.05.2023 në subjektin Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.. (Këtu e tutje OST sh.a.).

Titulli: Projekt Raport auditimi “Mbi përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë” në OST sh.a. për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022.

Projekt Raporti i auditimit është i strukturuar në gjashtë kapituj. Në kapitullin e parë të hyrjes janë trajtuar çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve, etj. Në vijim është përshkrimi i auditimit, në të cilin trajtohet një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit. Në kreun e tretë jepet konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit, bazuar në rezultatet e auditimit. Gjetjet dhe rekomandimet të strukturuar sipas llojit të tyre janë vendosur në kreun e katërt. Projekt Raporti ka në kreun e pestë anekse dhe mbyllet me kreun VI-Lista e dokumenteve të auditimit.

Marrësi: Operatori i Sistemit të Transmetimit, z. S. D. me detyrë Administrator.

Objektivat dhe qëllimi: Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse QKUM në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie dhe rregullshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuarra i shkëlqes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Auditimi i përputhshmërisë dhe i rregullshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e proceseve dhe aktiviteteve të institucionit.

Identifikimi i çështjes: Projekt Raporti mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të QKUM-së për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, ka identifikuar sipas kriterëve specifikë të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

Auditim me zgjedhje në disa Njësi Operative të Transmetimit

Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori) dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra.

Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve.

Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve.

Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla

(shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.)

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Strukturat drejtuese, duhet të orientojnë strukturat e institucionit, për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.

Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Kriteret e vlerësimit: Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Manualet e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH.

LIGJ NR. 43 DATE 30.04.2015 “PËR SEKTORIN E ENERGIJË ELEKTRIKE”

LIGJ-NR.-7-2018-DAT-15.2.2018 “PËR SEKTORIN E ENERGIJË ELEKTRIKE”

Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;

Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”;

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar” me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020.

Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar;

Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”

Ligji Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar;

VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar;

Vendim Nr. 244, Datë 30.3.2016, “Për Miratimin E Kushteve Për Vendosjen E Detyrimit Të Shërbimit Publik, Që Do Të Zbatohen Ndaj Të Licencuarve Në Sektorin E Energjisë Elektrike, Të Cilët Ushtrijnë Aktivitetin E Prodhimit, Transmetimit, Shpërndarjes Dhe Furnizimit Me Energji

Elektrike”.

Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”;

Standardet e auditimit: Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400-Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; si dhe në praktikat më të mira të fushës.

Metodat e auditimit: Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e QKUM-së., kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me akt konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt Raporti.

Dokumentimi i auditimit: Është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

OST sh.a. është krijuar më 14 Korrik 2004, si rezultat i reformimit dhe ndarjes së Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, nga një shoqëri e organizuar vertikalisht me funksione të gjenerimit, transmetimit dhe Shpërndarjes së energjisë elektrike, në tre shoqëri të veçanta. OST kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Dispečimit dhe Operatorit të tregut.

III.2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre

konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit.

III.2.1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së

Sa i përket masave organizative, pas verifikimit mbi zbatimin e rekomandimeve situata paraqitet si më poshtë:

Është zbatuar plotësisht rekomandimi nr. **1.1, 5.1, 6.3, 9.1, 12.1, 16.1, 17.1, 21.1**, :

Janë në proces zbatimi rekomandimet si më poshtë:

2.1.Rekomandimi: Nga Njësia e Prokurimit në OST sh.a, në hartimin e kërkesave për kualifikim të Dokumenteve Standarde të Tenderit, për provimin e kapaciteteve profesionale nga OE duhet të argumentojë një për një të gjitha kërkesat, duke pasur për bazë objektin e prokurimit si dhe zërat e volumet e punës të parashikuara në preventiv, duke mundësuar sa më shumë të jetë e mundshme konkurrimin e biznesit të mesëm e të vogël me qëllim rritjen e ekonomicitetit dhe efijencës së prokurimit.

3.1.Rekomandimi: Të merren masat që nga Njësia e Prokurimit në OST sh.a në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në kërkesat për kualifikim si pjesë e Dokumenteve Standarde të Tenderit, me qëllim provimin nga Operatorët Ekonomikë të kapaciteteve profesionale duhet, ti argumentojë një për një të gjitha kërkesat për licenca profesionale të kërkuar, a duke pasur për bazë objektin e prokurimit si dhe zërat e volumet e punës të parashikuara në preventiv.

4.1.Rekomandimi: Të merren masat që nga Njësia e Prokurimit në OST sh.a në cilësinë e Autoritetit Kontraktor që modifikimet e Dokumenteve Standarde të Tenderit, të argumentojë e dokumentojë arsyet që çojnë në këto modifikime.

6.1.Rekomandimi: Shoqëria OST sh.a, duhet të forcojë kontrollin e brendshëm, që krahas punës së një komisioni, që në këtë rast është caktuar për përlllogaritjen e fondit limit, të monitorojë procesin, duke verifikuar përlllogaritjet si nga ana e Njesisë së Prokurimit, ashtu edhe nga drejtuesit që miratojnë veprimet përkatëse, me synim përcaktimin e saktë të vlerës së prokurimit dhe shmangien e humbjeve nga realizimi i kontratave.

6.2.Rekomandime: Njësia e Prokurimit duhet të argumentojë çdo kriter kualifikimi sipas madhësisë dhe llojit të kontratës, për të mundësuar një pjesëmarrje sa më të gjerë të OE në procedurat e prokurimit, duke stimuluar edhe pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm.

7.1Rekomandimi: Nga ana e KVO duhet shqyrtuar me kujdes dokumentacioni i paraqitur nga OE pjesëmarrës në tender, për realizimin e një procesi vlerësimi sa më të saktë. Komisionet e Shqyrtimit të Ankesave duhet të analizojnë dokumentet e ankesave me korrektësi, duke shmangur edhe gabimet e mundshme të vlerësimit të KVO.

10.1Rekomandimi: Administratori i OST sh.a, Departamenti i Rrjetit të Transmetimit, Drejtoria e Shfrytëzimit, Mirëmbajtjes dhe Transmetimit, të marrin masa që në të ardhmen, të ndiqen dhe monitorohen me rigorozitet protokollat e mirëmbajtjes së pajisjeve të rrjetit të transmetimit, me qëllim mbajtjen e tyre në funksion dhe në rast defekti, të nxirren përgjegjësitë për personat përgjegjës për parandalimin e rasteve të ngjashme për mos të sjellë në të ardhmen, shpenzime të paparashikuara me pasoja negative financiare për OST sh.a.

11.1 Rekomandimi: OST sh.a të marrë masa që pas analizimit sipas sektorëve të shoqërisë mbi nevojat aktuale dhe progresive për mallra, punë e shërbime të hartojë regjistrin e parashikimeve

për procedurat e blerjeve të vogla sipas kërkesave të strukturave që hartojnë nevojat për mallra, punë e shërbime në mënyrë të atillë, që mos të ketë diskordancë në sasinë e realizuar të procedurave të blerjeve të vogla dhe sasinë e planifikuar për realizim, për një përdorim të fondeve publike me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet.

12.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa, që në procedurat për blerje karburanti që do të zhvillojë në të ardhmen, të koordinojë strukturat përkatëse për studimin e tregut dhe në përzgjedhjen e operatorëve fitues për procedurat e blerjes së karburantit të bazohet në marzhin e fitimit të marrë si çmim tavan, për përllogaritjen e fondit limit në mënyrë që të garantojë realizimin me sukses të kontratave të karburantit, pa sjellë diferenca në sasinë e parashikuara dhe të realizuara të këtij malli.

13.1.Rekomandimi: Departamenti i Operimit të Sistemit dhe grupi i ngritur për hartimin e programit ekonomik të kërkojnë nga strukturat përkatëse të vartësisë që krahas relacionit mbi nevojat për investime, fondet e parashikuara të jenë të argumentuara dhe ti referohen kontratave të mëparshme të ngjashme.

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Operimit të Sistemit në bashkëpunim me Drejtorinë e IT për procedurat e prokurimit në fushën e investimeve në sistemet hardëare-ike kompjuterike, të hartojnë dhe miratojnë modele standard të specifikimeve teknike për nevojat e DOS në fushën e informatizimit të sistemeve SCADA.

15.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor i OST-së, të vlerësoj me përgjegjshmëri objektin e kontratave që prokuron, duke mos përfshirë mallra apo shërbimeve të natyrave të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën.

18.1.Rekomandimi: Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave, pasi në disa raste hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave, konstatohet jo korrekt.

19.1.Rekomandimi: Drejtoria e IT së OST sh.a të marrë masat e nevojshme, për rivendosjen e arkivit të sistemit DAMAS për vitin 2018 dhe 2019 mbi procedurat e kryera për blerjen e humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit të energjisë.

20.1.Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në OST sh.a të plotësojë dhe përditësojë të gjitha dosjet e punonjësve me dokumentacion e përcaktuar sipas kriterëve ligjorë dhe kontratat e punës me punonjësit ku të specifikohet qartë pozicioni i punës në përputhje me nivelin arsimor dhe profesional të çdo punonjësi si dhe paga bruto për periudhën e punësimit.

20.2 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në OST sh.a të marrë masa për të hartojë rregulla dhe procedura specifike ku të përcaktohen qartë kriteret e punësimit për çdo pozicion pune lidhur specialitetin e nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë apo trajnimet profesionale të nevojshme për përmbushjen efikase të detyrave për çdo pozicion pune, duke rritur transparencën e mënyrës së punësimit dhe rekrutimit në bazë të meritokracisë, gjithashtu të dokumentojë procesin e konkurrimit dhe vendimmarrjes për marrjen në punë të punonjësve të shoqërisë.

22.1Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të merren masa që në të ardhmen, që pasqyrat financiare të hartohen, aprovohen dhe depozitohen brenda afateve ligjore, duke mundësuar vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike lidhur me vendim-marrjet që duhet të marrin palët e interesuara për drejtimin e shoqërisë, si asambleja e ortakëve, institucione kredidhënëse, etj.

23.1 Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë të merren masa që në të ardhmen, të ndiqet me përgjegjshmëri procesi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme në regjistrat e ASHK, si dhe pajisja e tyre me certifikatën e pronësisë.

24.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë në zbatim të legjislacionit, por edhe me bashkëpunimin e të gjithë aktorëve, të marrë masat për njohjen e detyrimeve të ndërsjella, duke gjetur dhe propozuar zgjidhjet e nevojshme, qoftë edhe nëpërmjet mekanizmit të shuarjes me kompensim të detyrimeve të ndërsjella, i cili do të ndikojë në uljen e detyrimeve dhe përmirësimin e situatës financiare të sistemit energjetik në vend, duke ofruar në këtë mënyrë një pasqyrim më realist financiar të shoqërive që operojnë në tregun energjetik.

25.1 Rekomandimi: OST sh.a të marrë masa për rritjen e monitorimit të proceseve dhe përmirësimin e sistemeve, duke synuar përmirësimin në tërësi të kontrollit të brendshëm.

26.1 Rekomandimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marrë masa për përmirësimin e proceseve të auditimit, duke vlerësuar riskun dhe numrin e auditimeve, me synim dhënien e një sigurie të arsyeshme për funksionimin e sistemeve.

27.1 Rekomandimi: Nga ana e Administratorit të OST sh.a të merren masat e nevojshme që, për të gjitha rastet kur punonjësit dërgohen me shërbim jashtë vendit sipas detyrës funksionale, të përcaktohen saktë shpenzimet me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve të parashikuara në buxhetin e shoqërisë për këtë zë të shpenzimeve.

Nuk është zbatuar rekomandim nr. **8.1**:

8.1 Rekomandimi: Nga ana e Autoritetit Kontraktor duhet të bëhen analiza kosto përfitim për kontratat e parashikuara. Projektzbatimi dhe preventivi i punimeve duhen realizuar para hapjes së procedurës së prokurimit, duke qenë se punimet e nënstacioneve dhe të linjave janë të standardizuara në tërësi.

Administratori i OST sh.a, Departamenti i Rrjetit të Transmetimit, të marrin masa që në të ardhmen, projektet inxhinierike në sektorin e energjisë, të hartohen nga specialistët me profesion në fushat inxhinierike që disponon Drejtoria e Planifikim Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit, duke ulur në këtë mënyrë shpenzimet e tepërta e për të mos rënduar buxhetin e shoqërisë

Sa i përket masave shpërblim dëmi, pas verifikimit mbi zbatimin e rekomandimeve situata paraqitet si më poshtë:

Është në proces zbatimi rekomandimet nr. **2.1**:

2.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë OST sh.a të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **701,470 lekë**, nga Kontraktori “**B... N**”, për punime të pa realizuara në zbatimin e kontratës me objekt “Sistemimi i problematikave të drenazhimit të ujërave të përmytjeve në N/stacionin 400/220/110 kV Tirana 2”.

Janë zbatuar rekomandimet nr. **1.1, 3.1, 4.1, 5.1**.

Sa i përket masave për eliminimin e efekteve negative, pas verifikimit mbi zbatimin e rekomandimeve situata paraqitet si më poshtë:

Janë në proces zbatimi rekomandimet nr. :

1.1Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për shqyrtimin e efektit negativ financiar në *vlerën 36,268,712 lekë*, si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, ardhur si pasojë e moszbatimit të procedurave ligjore në largimin e punonjësve nga puna, si dhe të analizojë në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna dhe krijimin e detyrimeve të shtuara, duke evidentuar përgjegjësitë individuale të strukturave përkatëse të OST sha.

2.1.Rekomandimi: Administratori i OST sh.a të marrë masa për shqyrtimin e efektit negativ financiar në *vlerën 2,817,000 lekë*, ardhur si pasojë e mosrealizimit të trajnimit të personelit operues të nënstacionit Tirana 2 të parashikuar në kontratën nr. 284/15 Prot. datë 23.05.2019.

3.1Rekomandimi: Nga ana e Administratorit të OST sh.a, të merren masa për shqyrtimin e efektit negativ financiar në *shumën 59,749,333 lekë*, si dhe të merren masat e nevojshme që në përcaktimin e llojit të procedurës së prokurimit dhe formës së kontratës të mbahet parasysh në çdo rast shfrytëzimi i të gjitha burimeve të brendshme intelektuale për sa është e mundur në hartimin e Projekteve në kontratat e punëve dhe në pamundësi të operohet me prokurimin e projekteve dhe pastaj me prokurimin e kontratës së punëve, kjo me qëllim garantimin e konkurrencës e transparencës në përdorimin e fondeve publike.

1. Titulli i gjetjes:	Rekomandime të cilat akoma nuk janë finalizuar.
Situata:	Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Operatorin e Sistemit të Transmetimit administruar në KLSH me nr. 1188/6 prot., datë 07.08.2019, janë rekomanduar gjithsej: - 27 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 8 masa, , në proces zbatimi 18 masa dhe të pa zbatuara 1 masë. - 5 masa shpërblim dëmi, nga të cilat janë zbatuar 4 masa, , në proces zbatimi 3 masa.
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “j”.
Efekti/Ndikimi:	Realizimi i rekomandimeve ndihmon shoqërinë OST sh.a. të arrijë objektivat dhe të përmbush misionin.
Shkaku	Nga ana e shoqërisë ka pasur përpjekje për realizimin e rekomandimeve, por nuk ka arritur t’i realizojë plotësisht.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	OST sh.a. të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, me synim realizimin e objektivave dhe në përmbushjen e misionit të shoqërisë.

II.2.2 Auditim me zgjedhje në disa Njësi Operative të Transmetimit

Në zbatim të pikës nr. 10, të Programit të Auditimit nr.222/1 Prot., datë 16.03.2023, i ndryshuar, “*Auditim me zgjedhje në disa Njësi Operative të Transmetimit*” u bë i mundur verifikimi fizik i Njesisë së Mirëmbajtjes së Transmetimit, si një si kryesore, dhe me aktivitete më të lartë se njësitë e tjera, duke u parë si një nga njësitë më me risk.

Verifikimi u krye nga dy audituesit z. E. K. dhe z. J. B., në prani të Drejtorit të Njesisë së Mirëmbajtjes së Transmetimit, z. V. S..

Auditimi konsistoi në verifikimin e magazinës, pasi gjatë analizimit të inventarëve dhe magazinës nga kontrolli nga zyra, lindën dyshime mbi vlerën e konsiderueshme të zërit 3125001 Pjesë Ndërrimi në vlerën 36,345,143 lekë.

Nga verifikimi rezultoi:

- Pjesët e ndërrimit, ishin të mbartura në vite, dhe nuk ishin pjesë të prokuruar vitet e fundit. Kjo pasi mirëmbajtja dhe servisi i automjeteve bëhet me anë të procedurave të prokurimi.
- Pjesët e ndërrimit janë propozuar disa herë që të nxirren jashtë përdorimi, por nga arsyetimi i drejtuesit të njësisë që mund të përdoren akoma për disa nga makineritë që janë në funksion dhe për hapësirat e papërfillshme që zënë, janë mbajtur akoma. (ilustruar me foto)



- Grupi i auditimit verifikoi dhe mjetet e tjera në lidhje me gjendjen e tyre, pasi rëndësia e përdorimit të tyre, që si funksion kanë shërbimin për avaritë e shkallës së lartë të krijuara në njësitë e tjera, ku rezultoi se mjetet ishin në gjendje të mirë, të mirëmbajtura dhe gjithashtu të pastra. (ilustrua me foto)



II.2.3 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori) dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra

Në zbatim të Pikës 3 të Programit të Auditimit nr .222/1 Prot. datë 16.03.2023, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori) dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra.”. u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).

OST sh.a. është shoqëri me kapital 100% shtetëror, me pronar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Shoqëria OST sha funksionon bazuar në kuadrin ligjor të përcaktuar sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Organet e shoqërisë janë: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë. Ministri në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, neni 135, pika 4, ushtron i vetëm të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme. Shoqëria është e organizuar sipas sistemit me dy nivele, ku funksionet e mbikëqyrjes ushtrohen nga Këshilli Mbikëqyrës, ndërsa funksionet e administrimit nga Administratori.

-Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë OST sh.a, përbëhet nga 6 anëtarë, secili nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mban detyrën për 3 vite, me të drejtë rizgjedhje.

OST sha operon bazuar me statutin e shoqërisë të miratuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 1, datë 29.01.2009. Rezulton se, statuti në kuadër dhe me ndryshimet në fushën e energjisë me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe me vendimin nr. 171, datë 25.2.2015 “Për miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike”, ka pësuar ndryshime dhe me Vendimin nr. 87, datë 05.12.2019 “Për aprovimin e një shtese në statutin e OST sh.a., dhe propozimin për miratimin e saj në Asamblenë e Përgjithshme të OST sh.a.” e cila është e miratuar nga Asambleja dhe është reflektuar në QKB.

Në lidhje me këtë pikë të auditimit janë marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:

-Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës për vitet 2021, 2022 sipas programit të Auditimit “Nr.222/1Prot. datë 16.03.2023”.

Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., për vitin 2021 ka zhvilluar nëpërmjet telekonferencës 7 mbledhje. Janë miratuar gjithsej 15 vendime. Më poshtë jepet një informacion mbi mbledhjet e organizuara, materialet e shqyrtuara, pjesëmarrjen në mbledhje dhe vendimet e marra.

Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., për periudhën Janar-Qershor 2022 ka zhvilluar nëpërmjet video-konferencës (në kohë reale), nëpërmjet platformës Microsoft Team, 8 mbledhje. Janë miratuar gjithsej 6 vendime.

Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., për periudhën Korrik-Dhjetor 2022 ka zhvilluar nëpërmjet video-konferencës (në kohë reale), nëpërmjet platformës Microsoft Team, 4 mbledhje. Janë miratuar gjithsej 9 vendime.

Në mbledhjet e zhvilluara, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk kanë qenë të gjithë prezent në mbledhjet e zhvilluara. Në përgjithësi u konstatua se, vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës për

periudhën objekt auditimi, vendimet kryesisht janë për miratimin e strukturës organizative, miratimi i analizave financiare, miratimi i rregullores së brendshme së bashku me përshkrimet e punës për secilin punonjës, nxjerrja jashtë përdorimi të aktiveve, si dhe shpërblimin e punonjësve të shoqërisë.

Nga auditimi konstatohet se, nga ana e sekretares së Këshillit Mbikëqyrës administrohen materialet dokumentare që i përkasin procedurave të mbledhjeve të zhvilluara dhe vendimmarrjeve konkrete të Këshillit Mbikëqyrës ato janë të plota dhe të rregullta nga ana formale juridike. Në përgjithësi mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të zhvilluara për këtë periudhë të aktivitetit të këtij këshilli të OST kanë pasur si objekt vendimmarrje, raportimin e ecurisë së veprimtarisë, miratimin e programit vjetorë, si dhe veprimtarinë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë dhe ndryshimet të propozuara nga Administratori i OST sha.

Nga auditimi rezulton se, mbledhjet janë zhvilluar sipas njoftimeve dhe relacioneve të paraqitura nga ana e Administratorit të OST sha, njoftimi i anëtarëve të Këshillit është kryer sipas afateve dhe qëllimit për zhvillimin e mbledhjeve kjo në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar. Në regjistrin e mbajtur për këtë qëllim evidentohen respektivisht, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët kanë qenë prezent dhe cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhje.

Në Këshillin Mbikëqyrës të OST sha ka pasur ndryshime në vitin 2021 dhe 2022 me vendime të Asamblesë së Përgjithshme e konkretisht:

-Sipas vendimit nr. 2679 prot., datë 11.02.2022 është liruar nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të OST sha znj. V. J. dhe është emëruar z. N. L. përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-Sipas vendimit nr. 94 prot., datë 06.01.2022 është liruar nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të OST sha z. N. L. dhe është bërë emërimi i znj. S. H. dhe znj. V. J., përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-Z. E. Xh. ka dhënë dorëheqjen me letrën nr.5122/2 prot., përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dt.22.06.2021 me objekt “Njoftim për dhënie dorëheqje”.

II.2.4 Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit nr. 222/1 Prot., datë 16.03.2023, i ndryshuar. “*Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve*” u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).

Nga grupi i auditimit u verifikuan:

- Struktura organizative
- Dosjet e personelit
- Rregullorja për përcaktimin e e kritereve të punësimit sipas pozicionit të vendit të punës
- Kontrata kolektive dhe ato individuale të punës
- Procedurat e rekrutimit dhe përfundimit të marrëdhënieve të punës
- Procedurat e dhënies të masave disiplinore

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

Organet drejtuese të OST sh.a. janë

Administratori, z. S. D. dhe

Nr.	Periudha	Mungesa të pajustificuara	Dorëheqje	Dalje në pension	Dalje në Kemp	Zgjidhje Kontrate	Përfundimi i Kontratës së Punës	Total
1	2022	7	47	24	-		1	79

Burimi: Të dhënat nga OST, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Në tabelën më poshtë pasqyrohen të dhënat mbi realizimin e zërave të shpenzimeve për periudhën objekt auditimi për personelin si fondi i pagave, pagesa për turne dhe orë jashtë orarit, shpenzime ushqimi për punonjësit, shpenzime për udhëtime dhe dieta, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, shpenzime page për vjetërsi në punë, fondi suplementar i pensionit, shpenzime të tjera për personelin.

Realizimi i zërave të shpenzimeve për personelin

Mln/lekë

Emërtimi	Viti 2022		%
	Plan	Fakt	
Fondi i pagave	797.5	758.0	95
Pagesa për turne dhe orë jashtë orarit	48.9	49.1	100
Shpenzime ushqimi për punonjësit	93.1	87.4	94
Shpenzime për udhëtime dhe dieta	34.3	20.53	60
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	158.3	158.4	100
Shpenzime page për vjetërsi në punë	92.9	88.8	96
Fondi suplementar i pensionit	43.1	42.7	99
Shpenzime të tjera për personelin	104.6	42.3	40.4
Totali	1,372.6	1,247.4	91
Nr. mesatar i punonjësve (nr.)	806	779	96.7

Burimi: Të dhënat nga OST, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Në tabelën më poshtë pasqyrohen të dhënat mbi numrin e punonjësve për periudhën objekt auditimi

Numri i punonjësve në OST sh.a. për periudhën objekt auditimi sipas strukturave

Emërtimi	Punonjës të përhershëm		Punonjës të përkohshëm	
	2022		2022	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Aparati Qendror	257	255	-	-
NJMT	55	53	-	-
NJOT	112	109	-	-
NJOE	63	62	-	-
NJOF	99	92	-	-
NJOK	45	42	-	-
NJOSH	110	109	-	-
NJOB	65	57	-	-
Totali	806	779	-	-

Të dhënat nga OST, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Në tabelën më poshtë pasqyrohen të dhënat mbi emërimet e reja

Emërimet e reja për vitin 2022 sipas strukturave të OST:

Nr	Njësitë operative	Viti
		2022
1	Administrata Qendrore	20
2	Njësia Operative Burrel	3
3	Njësia e Mirëmbajtjes së Transmetimit	4
4	Njësia Operative Tiranë	9
5	Njësia Operative Elbasan	4
6	Njësia Operative Korçë	3
7	Njësia Operative Fier	11
8	Njësia Operative Shkodër	6
	Gjithsej	60

Burimi: Të dhënat nga OST, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Mbi organizimin, rregullsinë dhe mbajtjen e dosjeve të personelit dhe rekrutimin e punonjësve sipas kriterëve të përcaktuara.

Nga grupi i auditimit u audituan 10 dosje personeli.

Në asnjë prej dosjeve nuk gjendej praktika e konkurrimit për vendet e punës të emëruar, ndërsa në disa të tjera mungonte jetëshkrimi i punonjësit, duke mos gjetur zbatim VKM Nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit.”, lidhja 2:

“Të dhënat që do të përmbajë dosja duhet të shoqërohen me dokumentin përkatës që vërteton pohimin e bërë : a) Certifikata e gjendjes familjare
 b) Diploma e shkollës së lartë, lista e notave
 c) Certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose specializimeve
 d) Libreza e punës
 e) Dokumenti i laurimit me gradë shkencore
 f) Të tjera...”

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës ku, Sektori i Personelit dhe Burimeve Njerëzore, mban dosjet e personelit dhe të dhënat e të gjithë të punësuarve në Shoqëri. Sektori i Burimeve Njerëzore duhet të zhvillojë mundësitë për trajnim, për të siguruar programe të vazhdueshme, të përshtatshme për të kënaqur nevojat e gjithsecilit për sa i përket planifikimit të karrierës.

Lidhur me hartimin e kontratave individuale, nuk ka gjetur zbatim neni 21 “Forma e kontratës së Punës”, i “Kodit të Punës”, ndryshuar, pika 3, germa h, ku cilësohet: “Kontrata e punës e lidhur me shkrim duhet të përmbajë sidomos elementët përbërës të pagës”.

Proceset gjyqësore për largime të punonjësve nga puna të ngritura, gjatë periudhës objekt auditimi:

Tabela e statusit të proceseve gjyqësore për largime të punonjësve nga puna:

Periudha	Padite s	I paditur	Objekti	Viti i hapjes se procesit gjyqësor	Shkalla I-rë	Apeli	Statusi aktual

2022	-	-	-	-	-	-	-
2021	I. P.	OST	Demshperblim page ne masen e 17 muajve+vjetersi	2021	Pranim i padise	Eshte bere ankim	Ne proces
2021	G. C.	OST	Demshperblim page ne masen e 12 muajve	2021	Ne proces	-	Ne proces

Burimi: Të dhënat nga OST, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Referuar tabelës së mësipërme për periudhën objekt auditimi, u konstatuan 2 procese gjygjësore të ngritura nga punonjësit e larguar nga puna, konkretisht referuar të dhënave nga Departamenti Ligjor dhe i Çështjeve Korporative për përfaqësimin e OST sh.a.

Për vitin 2022 nuk janë hapur proces gjyqësor padi kundër OST sh.a, me objekt “Ndërprerje e padrejtë e marrëdhënieve të punës”.

Nga auditimi për periudhën objekt auditimi konstatohet se shoqëria OST sh.a:

- Nuk ka gjurmë në asnjë rast në burimet njerëzore, për nevojat e sektorëve apo drejtorive;
- Për vitin 2022, OST sh.a nuk ka pasur një procedurë rekrutimi të punonjësve.
- Deri në përzgjedhjen e tyre nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura; nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar hapat që ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.
- Përzgjedhja e punonjësve nuk është bërë në çdo rast në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj;
- Për disa pozicione pune nuk është zbatuar kriteri i arsimit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligji 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, neni 21; VKM Nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit.”; Vendimi nr. 77, datë 23.07.2019 i Këshillit Mbikëqyrës, “Për miratimin e kriterëve të punësimi”; Ligji nr. 7598, date 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish të dënuarit e të përndjekurit politik"; ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

3. Titulli i Gjetjes:	Nuk ka gjurmë në asnjë rast në burimet njerëzore, për nevojat e sektorëve apo drejtorive
Situata:	Gjatë auditimit të pikës 4 të Programit të Auditimit “Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve”, në lidhje me rekrutimin e punonjësve të rinj, në asnjë rast nuk u evidentua ndonjë gjurmë që sektorëve/departamenteve përkatëse ju ka lindur nevoja për rekrutimin e punonjësve të rinj.
Kriteri:	Manuali i Burimeve njerëzore nr. 7862 Prot., datë 27.12.2016, i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Mos arritja e eficiencës në plotësimin e burimeve njerëzore

Shkaku:	Mos zbatimi i dispozitave ligjore dhe Vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	OST sh.a., gjatë hartimit të strukturës organizative të aparatit qendror OST sh.a. dhe njësive të vartësisë, dhe në momentin e plotësimit të strukturës me punonjës të rinj, të marrë në konsideratë nevojat e sektorëve/departamenteve dhe njësive të vartësisë që të arrijnë eficiencën e plotë me qasjen me burimet njerëzore të duhura sipas nevojave.
4. Titulli i Gjetjes:	Për vitin 2022, OST sh.a nuk ka pasur një procedurë rekrutimi të punonjësve
Situata:	Gjatë auditimit të mënyrës së rekrutimi të punonjësve të rinj, nuk u dokumentua një procedurë e mirëfilltë e rekrutimit të tyre. Deri në përzgjedhjen e tyre nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura; nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar hapat që ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.
Kriteri:	Manuali i Burimeve njerëzore nr. 7862 Prot., datë 27.12.2016, i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Konkurrenca e ulët në zhvillimin e garës, për përzgjedhjen e konkurrentit të duhur
Shkaku:	Mos zbatimi i dispozitave ligjore dhe Vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	OST sh.a., gjatë rekrutimit të punonjësve të rinj, të kryejë procedurat sipas metodave më të mira dhe me të drejta, për zhvillimin e tyre me transparencë të plotë dhe konkurrencë të plotë, duke përzgjedhur kandidatin e duhur sipas nevojave të institucionit.
5. Titulli i Gjetjes:	Përzgjedhja e punonjësve nuk është bërë në çdo rast në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet
Situata:	Gjatë auditimit të dosjeve të personelit dhe të dokumentit mbi “Detyrat funksionale dhe Kriteret e punësimit për pozicionet e punës”, përzgjedhja e punonjësve nuk është bërë në çdo rast në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj;
Kriteri:	Vendimi nr. 9 datë 21.12.2021 “Për miratimin e strukturës organizative të aparatit qendror të OST sh.a..
Ndikimi/Efekti:	Mos realizimi i detyrave të përcaktuara në përshkrimin e punës
Shkaku:	Mos zbatimi i dispozitave ligjore dhe Vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	OST sh.a., gjatë rekrutimit të punonjësve të rinj, të marrë në konsideratë të gjithë kriteret e vendosura dhe të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës si dhe në Manualin e Burimeve Njerëzore.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Drejtoresha e Burimeve Njerëzore znj. M. Gj.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 222/9 prot, datë 18.07.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e znj. M. Gj., në cilësinë e Drejtorit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Duke qenë një shoqëri publike me 100% të aksioneve shtetërore, që në veprimtarinë e saj kryen aktivitet tërësisht teknik emërimet bëhen në bazë të nevojave të Drejtorive dhe Njësive Operative. Drejtoritë dhe Njësitë Operative paraqesin kërkesat e tyre pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për vendet vakante që kanë në sektorët e tyre.

Për sa i takon konstatimit që disa nga dosjet nuk përmbajnë jetëshkrim sqarojmë se dosjet e personelit të audituara përmbajnë jetëshkrimin e punonjësit (bashkëngjitur materiali).

Çdo kontratë pune si pjesë përbërëse të pandashme të saj ka gjithmonë aneksin e Kontratës Individuale të marrjes në punë, ku cilësohet: njësia organizative, funksioni, kualifikimi, niveli i pagës (bashkëngjitur materiali). Nga pikëpamja formale dokumenti bashkë me anekset përkatëse konsiderohet gjithmonë një i vetëm.

Drejtoritë dhe Njësitë Operative paraqesin kërkesat e tyre pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, për çdo nevojë që kanë sektorët e tyre, për plotësimin e vakancave

Rekrutimi i punonjësve në OST sh.a bëhet në përputhje me përcaktimet e Kapitullit II , të Kontratës Kolektive të Punës për punonjësit e OST sh.a., me nr. 8336 prot., datë 16.12.2019; Kapitulli I, i Manualit të Burimeve Njerëzore nr. 7862 prot., datë 30.09.2020, ku përcaktohet: “...Drejtuesit e Departamenteve paraqesin pranë DBNJ-së, kërkesën për plotësimin e pozicionit të lirë të punës...”, Dokumentin nr. 978/1 prot, datë 11.02.2022, “Detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në Aparatin Qendror të OST sh.a.(rishikuar sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a., nr.9, datë 21.12.2021), si dhe në përputhje me Vendimin nr.9 datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës “Për miratimin e strukturës organizative të Aparatit Qendror të OST sh.a.; Vendimin nr.10 datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës “Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Operative dhe Njesisë së Mirëmbajtje Transmetimit.

Në dosjet e personelit të audituara, punonjësit plotësojnë kriterin e arsimit për pozicionin e tyre të punës. Në tabelën më poshtë gjeni emrat e punonjësve sipas dosjeve të audituara, me arsimin përkatës dhe kriterin e punësimit.

Gjithashtu lutem nëse është e mundur, specifikimi i punonjësve të cilët nuk plotësojnë kriteret e përmendura më sipër.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Grupi i auditimit, mori në shqyrtim observacionin, ku për të cilin mban të njëjtin qëndrim, pasi gjetjet e përmendura nga grupi i auditimit vlerësohen në momentin e shqyrtimit të dosjeve dhe dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit. Gjithashtu për sa i përket kërkesës së fundit të paraqitur në lidhje se cilët punonjës nga dosjet që kemi audituar nuk plotësojnë kriteret e përmendura, vlen të përmendim se asnjë nga ato punonjës nuk kishin Diplomën Master Shkencor ose Ekuivalente, ashtu sic kërkohet në kriteret e punësimit.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

II.2.5 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit nr. 222/1 Prot., datë 16.03.2023, “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve” u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).

Në lidhje me auditimin e pikës së mësipërme të programit, grupit të auditimit ju vunë në dispozicion dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat e pozicionit financiar
- Pasqyrat e performancës financiare
- Pasqyrat e flukseve monetare (Cashflow)
- Pasqyrat e Ndryshimeve në Aktivitet Neto/ Fondet Neto

Më poshtë paraqiten të përmbledhura në një tabelë pasqyrat e pozicionit financiar, në mënyrë krahasuese:

<i>(shumat janë të shprehura në lekë)</i>		<u>OST sh.a.</u>	<u>OST sh.a.</u>
	<i>Shenime</i>	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Asete afatgjata			
Asete afatgjata materiale	6	48,928,765,928	54,375,608,977
Asete afatgjata jomateriale	7	178,449,077	253,657,891
Asete me të drejtë përdorimi	8	28,038,847	
Asete financiare	9	11,471,758	12,873,258
Llogari të arkëtueshme e të tjera	11	8,787,768,309	9,236,307,418
		57,934,493,919	63,878,447,544
Asete afatshkurtra			
Inventari	10	714,637,057	692,633,679
Llogari të arkëtueshme e të tjera	11	12,386,744,460	10,772,713,147
Asete financiare	9	20,815,750	20,230,000
Parapagimet dhe Shpenzimet e shtyra	12	1,564,988,039	1,613,000,385
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	13	4,706,171,573	3,744,588,000
		19,393,356,879	16,843,165,211
Totali i asetëve		77,327,850,798	80,721,612,755
Kapitali			
Kapitali aksionar	14	25,055,608,000	22,146,576,634
Rezerva ligjore	14	822,807,118	789,775,831
Rezerva nga rivlerësimi për huatë	14	1,833,375,545	1,777,961,593
Rezerva rivlerësimi për AAM	14	3,588,107,999	6,080,408,403
Rezerva të tjera	14	13,868,508	517,627,526
Fitime të pashpërndara		453,195,480	1,778,541,985
Fitim/humbje të vitit financiar		907,587,774	673,888,998
Totali kapitalit për pronarin		32,674,550,423	33,764,780,971
Kapital i pakices	14	106,875,000	106,875,000
Rezerva të tjera	14	(202,645)	(60,602)
Fitime të pashpërndara		(13,937,127)	(673,858)
Fitim/humbje të vitit financiar		(22,237,162)	(13,263,269)
Totali interesi pakices		70,498,065	92,877,271
Totali I kapitalit aksionar		32,745,048,488	33,857,658,242
Detyrimet afatgjata			
Huatë	15	13,418,044,467	15,143,081,232
Llogari të pagueshme	16	3,417,124,425	2,129,659,443
Grantet	17	1,155,575,856	1,165,183,962
Detyrimi i qerase	8	26,991,103	
Tatime të shtyra për AAM	18	781,655,599	1,419,824,653
		18,799,391,450	19,857,749,289
Detyrimet afatshkurtra			
Huatë	15	15,143,428,546	17,062,895,119
Llogari të pagueshme	16	9,959,035,190	9,639,059,577
Detyrimi i qerase	8	3,359,918	
Parapagime nga klientë	19	260,796,227	104,488,846
Të ardhura të shtyra	20	87,472,993	68,597,443
Tatim fitimi	28	329,317,985	131,164,240
		25,783,410,859	27,006,205,224
Totali I detyrimeve		44,582,802,309	46,863,954,513
Totali i kapitalit të vet dhe detyrimeve		77,327,850,798	80,721,612,755

Shoqëria ka kontraktuar një ekspert të jashtëm, i cili në përputhje me SNK 36 “zhvlerësimi i aktiveve” ka kryer testin e vlerësimit të aktiveve të saj afatgjata për vitin e mbyllur 2021, gjithashtu pasqyrat financiare të vitit 2021 janë audituar dhe nga auditues të pavarur, G. Pasqyrat financiare të shoqërisë janë audituar nga Auditues të Pavarur G. Th.

Nga analizimi i dokumentacioni të kërkuar më sipër si dhe nga analizimi i raporteve të auditimit nga auditues të pavarur, të kontraktuar nga shoqëria, grupi i auditimit konstatoi:

OST nuk i ka regjistruar të gjitha pronat në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Ndërtimet në proces përfaqësojnë ndërtimin e aktiveve të transmetimit, duke përfshirë kryesisht linja transmetimi dhe nënstacione. Njohja e aktiveve afatgjata materiale behet me vlerën e drejte ne mënyrë periodike çdo 5 vjet.

Hua për palët e treta lidhet me huan e dhënë për Albgaz sh.a me vendimin nr. 22, datë 13 qershor 2017, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a. Afati i maturimit të kredisë është dy vite. Sipas marrëveshjes mes OST dhe Albgaz Sh.a. huamarrësi ka për detyre kthimin e shumës se plote të huas me norme interesi 0 (zero) tek huadhënësi brenda dy viteve nga hyrja ne fuqi e kësaj marrëveshje. Me date 22/10/2019 është firmos Amendimi Nr.1 i marrëveshjes se mësipërme sipas të cilit Huamarrësi ka për detyrim kthimin e shumës se plote të huas tek Huadhënësi me norme interesi zero brenda tre viteve nga hyrja ne fuqi e marrëveshje, për të cilën ka kaluar afati.

Risku i likuiditetit përcaktohet si risku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. OST është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndodhura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer kreditë. Nga ana tjetër, shoqëria përballet me vonesa të konsiderueshme në arkëtimet e shitjeve që i ka bërë OSHEE Sh.a. për shërbimin e transmetimit të energjisë.

Në prill 2021, IFRS IC (Komiteti i Interpretimit) nxori gjithashtu një vendim të rendit të ditës në lidhje me trajtimin kontabël për kostot e konfigurimit dhe personalizimit të marrëveshjeve kompjuterike cloud. Ky udhëzim sqaroi se në mënyrë që një aktiv jo-material të kapitalizohet në lidhje me kostot e personalizimit dhe konfigurimit në një marrëveshje kompjuterike cloud, është e nevojshme që të ekzistojë kontrolli i aktivitetit bazë të softuerit ose që të ketë një aktiv jo-material të veçantë që plotëson përkufizimi në SNK 38 Aktivitet Jo-materiale. Duke qenë se shoqëria ka në pronësi të saj sisteme dhe platforma TI, të bëjë të mundur rregullimet përkatëse dhe të shohë nëse do ketë ndonjë ndikim material.

6. Titulli i Gjetjes:	OST nuk i ka regjistruar të gjitha pronat në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.
Situata:	Gjatë auditimit të Pasqyrave Financiare, në vlerësimin e aseteve, vihet re që OST sh.a. nuk i ka regjistruar të gjitha pronat në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Ndërtimet në proces përfaqësojnë ndërtimin e aktiveve të transmetimit, duke përfshirë kryesisht linja transmetimi dhe nënstacione. Njohja e aktiveve afatgjata materiale behet me vlerën e drejte ne mënyrë periodike çdo 5 vjet.
Kriteri:	SNK 16 Aktivitet Afatgjata Materiale
Ndikimi/Efekti:	Pasiguri në vijueshmërinë e punës dhe arritjen e objektivave të shoqërisë
Shkaku:	Mos bashkërendim i punës me institucionet e tjera përgjegjëse
Rëndësia:	E Lartë

Rekomandim:	OST, të bëjë të mundur ndjekjen dhe finalizimin e të gjitha procedurave në lidhje me regjistrimin e pronave në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.
7. Titulli i Gjetjes:	Kalimi i afateve të maturimi të huave dhënë të tretëve
Situata:	Gjatë auditimit të pasqyrave financiare vihet re që në zërin Hua për palët e treta që lidhet me huan e dhënë për Albgaz sh.a me vendimin nr. 22, datë 13 qershor 2017, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a. Afati i maturimit të kredisë është dy vite. Sipas marrëveshjes mes OST dhe Albgaz Sh.a. huamarrësi ka për detyre kthimin e shumës së plotë të huas me norme interesi 0 (zero) tek huadhënësi brenda dy viteve nga hyrja ne fuqi e kësaj marrëveshje. Me date 22/10/2019 është firmos Amendimi Nr.1 i marrëveshjes se mësipërme sipas të cilit Huamarrësi ka për detyrim kthimin e shumës së plotë të huas tek Huadhënësi me norme interesi zero brenda tre viteve nga hyrja ne fuqi e marrëveshje, për të cilën ka kaluar afati.
Kriteri:	Vendimi nr. 22, datë 13 qershor 2017, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a
Ndikimi/Efekti:	Vështirës në alokimin e huave
Shkaku:	Nuk janë marrë masat për arkëtimin e huas
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	OST sh.a., të marrë të gjitha masat mbi kthimin e shumës së plotë të huas nga Albgaz sh.a., duke iu përmbajtur kushteve të kontratës, dhe në rast të moskthimit të shumës nga ana e tyre të marrë masat mbi vendosjen e kamatëvonesave ose penalizimeve sipas kushteve të kontratës.
8. Titulli i Gjetjes:	Tendencë rritje e riskut mbi likuiditetin
Situata:	Gjatë auditimit të pasqyrave financiare vihet re një rritje në riskun mbi likuiditetit që përcaktohet si risku që njësi të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. OST është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndodhura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer kreditë. Nga ana tjetër, shoqëria përballet me vonesa të konsiderueshme në arkëtimet e shitjeve që i ka bërë OSHEE Sh.a. për shërbimin e transmetimit të energjisë.
Kriteri:	-
Ndikimi/Efekti:	Risk mbi mbulimin e shpenzimeve të vetë subjektit
Shkaku:	Nuk janë marrë masat e duhura për arkëtimin e shitjeve bërë ndaj OSHEE sh.a.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandim:	OST sh.a., të marrë të gjitha masat mbi arkëtimin e shitjeve që i ka bërë OSHEE sh.a. për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike si dhe në rast të vonesave mbi arkëtimin e tyre të marrë masat mbi vendosjen e kamatëvonesave duke iu përmbajtur kushteve të kontratës.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi

z. A. K., në cilësinë e Drejtorit Ekonomik dhe znj. A. Q. në cilësinë e shefes së Sek të Kontabilitetit dhe Taksave.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observation me shkresë nr. 222/9 prot, datë 18.07.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e z. A. K., në cilësinë e Drejtorit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Sic edhe ju kemi sqaruar gjatë auditimit tuaj pranë zyrave tona poashtu edhe në observacionin tonë mbi Akt konstatimin nr.4, nga ana e OST janë kryer aplikimet për regjistrimin e pronave në emër të OST sh.a. që në vitin 2015. Është detyrë e ASHK të kryejë regjistrimin e tyre ose të bëjë kërkesë për informacion shtesë për të përmbyllur këto procese. Gjithashtu adresimi i kësaj çështje dhe ngarkimi me përgjegjësi z. A. K. në cilësinë e Drejtorit Ekonomik dhe znj. A. Q. në cilësinë e shefes së kontabilitetit dhe taksave është e padrejtë, pasi ndjekja dhe regjistrimi i pronave të OST nuk është pjesë e detyrave funksionale e jona.

Për gjetjen nr. 7, përvec amendimit nr.1 të Marrëveshjes së huas të cituar, është firmosur me datë 07.08.2020 dhe amendimi nr.2 i marrëveshjes së mësipërme për të cilën huamarrësi kthen shumën brenda 4 viteve me normë 0 interesi. Gjithashtu me datë 28.07.2021 është firmosur amendimi i 3 që shuma të kthehet brenda 5 viteve. Për më tepër me shkresën nr. 318 Prot. datë 16.01.2023 OST i është drejtuar shoqërisë ALBgaz me kërkesë për shlyerjen e huasë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Grupi i auditimit bën të mundur konstatimin e situatës dhe dhënien e rekomandimeve të cilat i vijnë në ndihmë shoqërisë. Përgjegjësia e Drejtorisë Ekonomike në këtë rast lidhet me mënyrën dhe vlerën e regjistrimit të pronave mbi të cilën nuk ekzistojnë të drejta deri në momentin e regjistrimit të tyre. Gjithashtu dhe në rastin e huasë, duke krijuar pasiguri për alokimin e shumës si dhe në amendimin e kontratave për brenda disa viteve si dhe përcjelljen e shkresës për kthimin e shumës pas 1 viti.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

II.2.6 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave

Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) bazuar në Regjistrin e Realizimeve vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit në Sistemin e Prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, për gjatë vitit 2022 ka realizuar 37 procedura prokurimi me vlerë totale 3,716,128,266 lekë pa TVSH.

Bazuar në një analizë risku dhe në metodat e përzgjedhjes për auditim të procedurave të prokuruaru u vendos për auditimin e procedurave të mëposhtme:

2021					
Procedura e Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik	Data e lidhjes së kontratës	
1	Rinovimi i suportit dhe licensave të platformës elektronike financiare, burimeve njerëzore, archive elektronike dhe sistemit të menaxhimit të dokumentave	24,330,000	23,700,000	T. S.	07.10.2022

“Rinovimi i suportit dhe licensave të platformës elektronike financiare, burimeve njerëzore, archive elektronike dhe sistemit të menaxhimit të dokumenteve”

Përshkrimi i procedurës

“Rinovimi i suportit dhe licensave te platformës elektronike financiare, burimeve njerëzore, arshivës elektronike dhe sistemit te menaxhimit te dokumenteve, Fiskalizimit dhe Faturës elektronike Online dhe Migrimi ne versionin cloud”.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën 24,330,000 lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rinovimi i suportit dhe licensave të platformës elektronike financiare, burimeve njerëzore, archive elektronike dhe sistemit të menaxhimit të dokumentave”		
1. Urdhër Prokurimi Nr.138, datë 06.07.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur	2. Njësia e Prokurimit Znj. N. Xh. z. N. T. z. E. X.	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike: z. E. Xh. z. F. Sh. z. E. C.
4. Fondi limit (pa tvsh) 24,330,000 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i shoqërisë	6. Data e hapjes së tenderit 07.10.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës Tetra Solutions 23,700,000 b) kualifikuar: Tetra Solutions 23,700,000	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z. F. Sh. z. D. M. z. D. Sh.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 23,700,000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë shërbimi nr. 4257/13 datë 21.10.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 350,000 lekë	12. Ankimime S’ka
13. Struktura për ndjekjen e kontratës z. E. Xh.	14. Fletë hyrja Shërbim	15. Afati i kontratës 12 muaj

Zhvillimi i procedurës së mësipërme është kryer bazuar në shërbimet e mëposhtme:

1	2	3	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Njesia	Sasia
1	Hosting dhe migrimi i programeve ne versionin pasardhes Cloud		
1.1	- Oracle Financials (10 Users)	Set	1
	- Oracle Inventory Management (10 Users)	Set	1
	- Oracle Enterprise Asset Management (10 Users)	Set	1
	- Oracle Purchasing (5 Users)	Set	1
1.2	Sherbimi i zbatimi te sherbimit te Migrimit ne Cloud te Licensave mesiper, perfshire	Set	1
	- Setup te sistemit;	Set	1
	- Migrimin dhe hapjen e te dhenave ne sistemin e ri;	Set	1
	- Trajninin e personelit teknik per sistemin e ri;	Set	1
	- Pershtatjen dhe permiresimin e raporteve;	Set	1
	- Mbeshtetje ne vend pergjate periudhes fillestare 1 mujore;	Set	1
2	Mirembajtja e licensave dhe sherbimeve ekzistuese		
	- Oracle Human Resources, Self-Service HR (500 Employee)	Vite	1
	- @Paga (10 Users)	Vite	1
	- Arkives dhe te protokollit (ëorkfloë)	Vite	1
	- Sherbimi i fiskalizimit te fatures elektronike	Vite	1
3	Sherbime te lidhura me sistemet		
3.1	Sherbimi i suportit dhe mirembajtjes per ceshjte teknike dhe operacionale ne vend	Vite	1

9. Titulli i Gjetjes:	Parregullsi në procesin e vlerësimit të ofertave
Situata:	Gjatë verifikimi të dokumentacioni të ngarkuar në sistem nga ana e O.E. fitues, në lidhje me pikën 2.3.3 në Kriteret e Veçanta “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë suportin ose autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”, O.E. fitues ka paraqitur deklaratë nga Zyra e përfaqësisë Oracle në Shqipëri, Oracle N... B.V. Albania Representative Office. Nga hulumtimet e kryera nga grupi i auditimit në faqen zyrtare

	<p>të kompanisë Oracle, O.E. nuk rezulton të jetë partner i kompanisë Oracle, ashtu siç deklaroi.</p> <p><i>Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë certifikimet si më poshtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> · sisteme Oracle ERP; · sisteme BI; · infrastructure Cloud; · sisteme ERP Cloud; · sisteme për rrjetin e shpërndarjes (Supply Chain); · Certifikata e lëshuar nga Tatimet dhe AKSHI si prodhues dhe për mirëmbajtjen e softuerike për fiskalizimin me dhe pa para në dore, faturën elektronike si dhe faturën shoqëruese (që ofertohej). <p>periudha e vlefshmërisë së certifikimeve të mësipërme është deri më 29 Mars 2023, periudhë që nuk e mbulon të plotë shërbimin 1 vjeçar të Rinovimit të suportit dhe licencave.</p>
Kriteri:	Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Moszbatimi i legjislacionit në fuqi
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	OST, në rastin e vlerësimit të ofertave të kryhet vlerësim i drejtë dhe transparent duke u bazuar në bazën ligjore dhe udhëzimet përkatëse si dhe duke i dhënë gjithmonë përparësi ofertave më të ulëta në rast se përmbushin dokumentacionin e plotë të kërkuar dhe në rastin kur oferta është e dyshimtë mbi përmbushjen e disa kriterëve ose specifikimeve, të kërkohej informacion më tepër në lidhje me të, deri në sqarim e plotë të rastit.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi

Komisioni i Vlerësimit të ofertave z. D. M., z. E. Xh. dhe z. D. Sh.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 222/9 prot, datë 18.07.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e z. D. M., z. E. Xh. dhe z. D. Sh., në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Ne lidhje me qendrimin ku nga ana juaj konstatohet se O.E. Tetra Solutions nuk është në listen e partnereve të autorizuar nga kompania O., ju bejme me dije se ne linkun me poshte, e marr nga faqe zyrtare e o.com, mund të shikoni se kjo kompani rezultoi partner i listuar i O. (shihni dhe bashkelidhur):

<https://partner-finder.oracle.com/catalog/Partner/SCPP-UNOGGMEI>

Gjithashtu ju bejme me dije se zyra e perfaqesimit te Oracle ne Shqiperi rezultoi dhe e regjistruar zyrtarisht si e tille e regjistruar ne QKB (www.qkb.gov.al).

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e sjellë nga përfaqësuesit e subjektit në lidhje me listen e partnereve, ne likun e sjellë, O.E. që është partner është T.P. me nr. NIPT M.....F dhe jo T.S. me nr. NIPT K.....P me zotërues të ndryshëm.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj pranohet pjesërisht

- “Automjete me qira operationale Leasing”

Përshkrimi i procedurës

Për nevoja të Njësive Operative janë marrë automjetet me qira operationale leasing për 60 muaj, me të dhënat e mëposhtme:

Tre automjete Fuoristrad tip Pick Up, me karroceri me katër rrota aktive

Tre automjete Furgon, numri i vendeve 8+1

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën 35,500,000 lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Automjete me qira operationale Leasing ” 2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 1015/8, datë 12.09.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur	2. Njësia e Prokurimit z. K. G. z. D. D. z. N. T.	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike: z. K. G. z. N. Sh. z. E. B. z. D. D.
4. Fondi limit (pa tvsh) 35,500,000 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i Shoqërisë	6. Data e hapjes së tenderit 28.10.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës ASG sh.p.k. 35,450,000 lekë b) kualifikuar: ASG sh.p.k. 35,450,000 lekë	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z. D. M. znj. J. M. z. T. Q.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 35,450,000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë shërbimi nr. 1015/17 datë 14.11.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 50,000 lekë	12. Ankimime S'ka
13. Struktura për ndjekjen e kontratës z. D. D.	14. Fletë hyrja Shërbim	15. Afati i kontratës 63 muaj
16. Vlera e kontratës me TVSH 42,540,000 lekë	17. Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi	18. Likuiduar deri dt

Të gjithë shpenzimet e nevojshme për mirëmbajtjen e automjeteve, si:

- Ndërrim i vajit të motorit, filtrave të tjerë (karburantit, vajit, ajrit, kondicionerit, etj.) sipas afatit të manualit të automjetit.
- Ndërrim i vajit të kambios, sipas afatit të manualit të automjetit.
- Ndërrimin e gomave çdo 30,000 km ose me pare ne rast të dëmtimeve të renda.
- Ndërrimin e pjesëve të konsumit të automjeteve, në varësi të përdorimit të tyre, si ferrota, alkool frenash, alkool të sistemit të drejtimit, etj.

Për përlogaritjen e fondit limit është kryer testimi i tregut, ku janë marrë ofertat përkatëse sipas O.E. të mëposhtëm:

	C. sh.p.k.	A. M. C.	A.
Pick Up	917 euro/muaj	750 euro/muaj	833 euro/muaj
8+1	1,083 euro/ muaj	917 euro/ muaj	1000 euro/muaj

Bazuar në listën e mësipërme, duke marrë për bazë kursin e ditës 17.08.2022, fondi limit është përlllogaritur të jetë 35,500,000 lekë pa TVSH.

Për procedurën e prokurimit të mësipërme u krye dhe verifikimi në terren i automjeteve, për të cilat u mbajt dhe një Akt Verifikim, por që të dhënat do të përfshihen në këtë Akt Konstatim.

Grupi i auditimit verifikoi 3 automjetet 8+1, të cilat gjendeshin pranë Njesisë Qendrore të OST sh.a., ndërsa përse i përket 3 automjeteve të tjera tip Pick-up, nuk u kryer verifikimi, pasi ishin të shpërndara nëpër Njësitë e tjera, dhe verifikimi i tyre do të pengonte realizimin e detyrave nga ana e punonjësve që e kanë në përdorim.

Qëllimi i verifikimit nga grupi i auditimit ishte verifikimi nëse automjetet përkonin me specifikimet teknike të kërkuara nga A.K. dhe nëse për automjetet në fjalë gjendej libri i shërbimeve.

Nga verifikimi rezultoi se automjetet përkonin me specifikimet teknike të kërkuara, ndërsa përse i përket librit të shërbimit, nuk ishte i plotësuar pasi akoma nuk ishin plotësuar kilometrat për kryerjen e servise të automjeteve (10,000 km). (ilustruar me foto në Anekse).

Për sa më sipër, u konstatua:

Nga strukturat përgjegjëse të OST në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit, nuk është kryer një analizë kosto-përfitim në lidhje me automjetet e mësipërme, nëse do ishte menduar zhvillimi i procedurës për blerjen e tyre, duke analizuar përfitimin mbi përdorimin e tyre si dhe vlerën e mbetur pas 60 muajve (5 viteve), pasi nga studimet e kryera nga grupi i auditimit, nga vlera totale e kontratës prej 35,450,000 lekësh pa tvsh, përkon me çmimin për njësi (automjeti) prej 5,908,333 lekësh pa TVSH. Vlera e automjeteve në treg (të papërdorura), pas interesimit nga ana e grupi auditues përkon me vlerën max prej 3,000,000 lekë pa tvsh. Duke përfshirë koston e mirëmbajtjes vjetore, taksat vjetore si dhe siguracionin sipas standardeve ndërkombëtare (taksa vjetore sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë), vlera e automjetit, pas 5 vitesh do të arrinte në vlerën max prej 4,500,000 lekë pa TVSH. Duke zbritur normën e amortizimit të saj, automjeti pas 5 vitesh do të kishte akoma vlerë të mbetur, ose do ishte akoma në përdorim të shoqërisë.

10. Titulli i Gjetjes:	Nuk është kryer një analizë kosto-përfitim për zhvillimin e procedurës
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Automjete me qira operationale Leasing”, nga strukturat përgjegjëse të OST në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit, nuk është kryer një analizë kosto-përfitim në lidhje me automjetet e mësipërme, nëse do ishte menduar zhvillimi i procedurës për blerjen e tyre, duke analizuar përfitimin mbi përdorimin e tyre si dhe vlerën e mbetur pas 60 muajve (5 viteve).
Kriteri:	Ligji nr.10 296, Datë 8.7.2010 Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin
Ndikimi/Efekti:	Përdorimi pa 3E i fondeve të prokuruar
Shkaku:	Mos zhvillimi i një analizë kosto-përfitim
Rëndësia:	E Lartë

Rekomandim:	OST sh.a., në të ardhmen, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të kryejë një analizë kosto përfitim të tyre mbështetur në praktikat më të mira.
--------------------	---

- “Shërbimi privat i sigurisë fizike ”

Përshkrimi i procedurës

Për nevoja të institucionit u pa e nevojshëm prokurimi i procedurës me objekt “Shërbim privat i sigurisë fizike” i ndarë në dy lote.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën 440,190,290 lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Shërbimi privat i sigurisë fizike ” 2022		
1. Urdhër Prokurimi		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit Marrëveshje kuadër	2. Njësia e Prokurimit z. R. C. z. N. T. z. A. D.	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike: z. R. C. z. N. T. z. A. D.
4. Fondi limit (pa tvsh) 440,190,290 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i Shoqërisë	6. Data e hapjes së tenderit 20.04.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës Loti 1 T. shpk 142,764,418 Loti 2 F. RB 297,425,872	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z. D. M. znj. J. M. z. T. Q.	9. Oferta fituese (pa tvsh) Loti 1 T. shpk 142,764,418 Loti 2 F. RB 297,425,872
10. Data e lidhjes së kontratës 16.06.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) lekë	12. Ankimime S'ka
13. Struktura për ndjekjen e kontratës z. D. D.	14. Fletë hyrja Shërbim	15. Afati i kontratës 63 muaj
16. Vlera e kontratës me TVSH 42,540,000 lekë	17. Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi	18. Likuiduar deri dt

Gjatë analizimi të procedurës së mësipërme të prokurimit, në vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit ngarkuar në sistem nga O.E. fitues të procedurës u konstatua që në dokumentacionin e sjellë nuk citohet se cilët do jenë punonjësit me të cilët do të realizohet shërbimi, por janë mjaftuar me certifikatat për punonjës shërbimi, ku për të cilët janë sjellë në tërësi të gjitha certifikatat e lëshuara për të gjithë punonjësit e O.E..

Lista e punonjësve do të bënte të mundur dhe verifikimin nëse këto punonjës nuk janë angazhuar në kontrata të tjera të lidhura nga O.E. Gjithashtu nuk është kërkuar një listëpagesë e punonjësve e shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe një deklaratë bankare, pasi nga O.E. deklarohet që pagesa për punonjësit është në vlerën 66,359.88 lekë/roje/muaj.

11. Titulli i Gjetjes:	Parregullsi gjatë vlerësimit e ofertave
Situata:	Gjatë analizimi të procedurës së prokurimit me objekt “Shërbimi privat i sigurisë fizike”, në vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit ngarkuar në sistem nga O.E. fitues të procedurës u konstatua që në

	<p>dokumentacionin e sjellë nuk citohet se cilët do jenë punonjësit me të cilët do të realizohet shërbimi, por janë mjaftuar me certifikatat për punonjës shërbimi, ku për të cilët janë sjellë në tërësi të gjitha certifikatat e lëshuara për të gjithë punonjësit e O.E.</p> <p>Lista e punonjësve do të bënte të mundur dhe verifikimin nëse këto punonjës nuk janë angazhuar në kontrata të tjera të lidhura nga O.E. Gjithashtu nuk është kërkuar një listëpagesë e punonjësve e shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe një deklaratë bankare, pasi nga O.E. deklarohet që pagesa për punonjësit është në vlerën 66,359.88 lekë/roje/muaj.</p>
Kriteri:	VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim për zhvillimin e objektivave të shoqërisë dhe përmbushjen e kontratës së prokurimit
Shkaku:	Vlerësim jo i saktë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	OST sh.a., gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të marrë në konsideratë të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të detajuara të nevojshme si dhe gjatë vlerësimit të ofertave si dhe të bëjë verifikimet përkatëse me çdo institucion tjetër në lidhje me deklaratat e lëshuara nga O.E. pjesëmarrës në lidhje me pagës dhe sigurimet e derdhura për punonjësit e deklaruar.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi

Komisioni i Vlerësimi të ofertave z. D. M., znj. J. M. dhe z. T. Q.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.222/9 prot, datë 18.07.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e z. D. M. dhe z. T. Q., në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimi privat i sigurisë fizike”, ndarë në dy lote, është kërkuar që për secilin lot, ofertuesi të disponojë një sasi të caktuar punonjësish, në mënyrë që të mbulojë shërbimin në përputhje me Termat e Referencës së kësaj procedure, pra me tre turne dhe me shërbim për çdo ditë kalendarike.

Në këtë kuadër, ofertuesit përkatës, kanë paraqitur dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, ku janë specifikuar se disponojnë numrin e nevojshëm të punonjësve të kërkuar, si dhe certifikimet përkatëse të secilit.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, ka krijuar sigurinë që ofertuesit kanë kapacitetet e nevojshme njerëzore për të mbuluar të gjithë pozicionet e kërkuara me shërbim ruajtje nga punonjësit e vet, pavarësisht se nuk janë evidentuar emrat e këtyre punonjësve, pasi kjo nuk konsiderohet e rëndësishme, pasi një punonjës mund të zëvendësohet, të përftojë lejen e zakonshme të paguar sipas Kodit të Punës, të ndërpresë marrëdhënien e punës me punëdhënësit e tij (Kontraktorin), etj.

Me rëndësi është që vendi i shërbimit, që është marrë përsipër për t’u mbuluar nga Kontraktori, të jetë gjithmonë me një punonjës shërbimi dhe të plotësojë kriteret ligjore të përcaktuara në ligjin e posaçëm të sigurisë fizike.

Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka çmuar se ofertat e kualifikuara plotësojnë kriteret e vendosura në Dokumentet e Tenderit dhe rrjedhimisht Autoriteti Kontraktor ka nënshkruar kontratat publike.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Pas shqyrtimit të observacionit nga grupi i auditimit, A.K. është përgjegjëse të kryejë verifikimet e saj, kryesisht në procedurat që kanë lidhje me sigurinë e objekteve. Burimet njerëzore/ stafi teknike që përbëjnë kriter për kualifikimin në një procedurë prokurimi duhet të deklarohen që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera në mënyrë që garantohet

përbushja e qëllimit të shërbimit. Sa i sigurt është A.K. që O.E. nuk mund të garojë në procedura të tjera prokurimit me të njëjtin staf punonjësish. Gjithashtu nga ana e A.K. duhet të bëhen dhe verifikimet përkatëse në për çdo deklaratë të kryer nga O.E., kryesisht dhe për deklaratën në lidhje me derdhjen e pagave dhe kontributeve shoqërore.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

- Suport, licenca dhe mirëmbajtje për pajisjet Hardëare

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën 8,300,000 lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Suport, licenca dhe mirëmbajtje për pajisjet Hardëare”		
1. Urdhër Prokurimi Nr.4277/8, datë 12.09.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur	2. Njësia e Prokurimit z. R. K. z. K. P. z. N. T.	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike: z.R. K. z. K. P. z. M. M.
4. Fondi limit (pa tvsh) 8,300,000 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i shoqërisë	6. Data e hapjes së tenderit 07.10.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës C.C.S shpk 7,918,900 b) kualifikuar: C.C.S shpk 7,918,900	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z. D. M. z. E. Xh. z. D. Sh.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 7,918,900 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë shërbimi nr. 4277/13 datë 07.10.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 381,100 lekë	12. Ankimime S'ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës z. D. Sh. z. A. K. z. E. Xh.	14. Fletë hyrja Shërbim	15. Afati i kontratës 12 muaj

Procedurat e prokurimit të mësipërme konsiston në specifikat e mëposhtme:

I	2	3
Artikulli	Përshkrimi i shërbimeve	Sasia
1	Suport nga prodhuesi - Core Site HPE 5510 48G 4SFP+ HI Switch	2
2	Suport nga prodhuesi - NGFË dhe VPN Barracuda CloudGen Firewall Appliance F400	2
3	Suport nga prodhuesi - Sistemi NAC Aruba Networks ClearPass Platform (VM)	1
4	Suport nga prodhuesi - Sistemi NMS Aruba Airëave Management Platform (VM)	1
5	Suport nga prodhuesi - Akses Point Wi-Fi Aruba AP-303 (RË) Unified AP	25
6	Suport nga prodhuesi - Switch Aksesit Aruba 2930F 24port Gb PoE+ L3	11
7	Suport nga prodhuesi - Sëitch Aksesit Aruba 2930F 8port Gb PoE+ L3	11
8	Suport nga prodhuesi - VMware vSphere 7 Standard (Vëmëare Vsphere 10 procesore + Vëmëare Vcenter 1 instance) 24 Hours/Day, 7 Days/ëeek	1
9	Shërbime mujore të mirëmbajtjes (1 vit x 12 muaj)	12

Shërbimi i mirembajtjes për pajisjet dhe sistemet ku gjatë realizimit të këtij shërbimi, Kontraktori do të jetë përgjegjës për:

- Mirëmbajtjen e pajisjeve Firewall (hardëare dhe subscriptions);
- Mirëmbajtjen e sistemeve NAC dhe NMS;
- Mirëmbajtjen e pajisjeve të rrjetit në core;
- Mirëmbajtjen e pajisjeve sëitch në akses;
- Mirëmbajtjen e pajisjeve access point ëireless;
- Mirëmbajtjen e sistemit Vmëare

Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit, në hartimin e kriterëve të veçanta janë përfshirë në kriterin 2.3.4

Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin teknik si vijon:

- a. *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivelin profesional për dizejnimin e rrjetit.*
- b. *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për pajisjet e rrjetit të tipit switch.*
- c. *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për sistemin e menaxhimit të politikave të sigurisë dhe aksesit në rrjet.*
- d. *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për rrjetin ëireless.*
- e. *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet e sigurisë.*

Përdorimi i termit në këtë rast certifikuar nga prodhuesi kufizojnë konkurrencën dhe nuk janë në përputhje me objektin e kontratës dhe vlerën e kontratës. Procedura e hapur e thjeshtuar nuk duhet të ketë shumë kriterë, në mënyrë që të jetë e mundur përfshirja e biznesit të vogël dhe të mesëm. Gjithashtu në vlerësimin e ofertave vihet re që pika 2.3.3 e kriterëve të veçanta “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë suportin ose autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për pajisjet dhe platformat (Switche, NFGË, platforme NAC, sistemi NMS, Akses Point, Switche Aksesit)*”. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëb-site, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”, nuk përmbushet nga O.E. fitues, ku në dokumentet e ngarkuara nga O.E. në sistemin elektronik të APP, gjendej vetëm një autorizim nga Heëlet Packard me anë të e-mailit, ku dhe kjo e fundit nuk i mbulon të gjitha artikujt në specifikimet teknike.

12. Titulli i Gjetjes:	Parregullsi gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta
Situata:	Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt “Suport, licenca dhe mirëmbajtje për pajisjet Hardëare”, në hartimin e kriterëve të veçanta janë përfshirë në kriterin 2.3.4 Përdorimi i termit në këtë rast certifikuar nga prodhuesi kufizojnë konkurrencën dhe nuk janë në përputhje me objektin e kontratës dhe vlerën e kontratës. Procedura e hapur e thjeshtuar nuk duhet të ketë shumë kriterë, në mënyrë që të jetë e mundur përfshirja e biznesit të vogël dhe të mesëm.
Kriteri:	Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Pengesë në zhvillimin e një gare dhe konkurrence të drejtë

Shkaku:	Vendosja e kriterëve jo në proporcion me vlerën e kontratës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	OST sh.a., gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të mirëmbajtjes së pajisjeve hardëare, të krijojë kushte me gjithëpërfshirëse, pasi vendosja e kriterëve të cilët kërkojnë certifikime të prodhuesve pengojnë zhvillimin e një gare dhe konkurrence të drejtë.
13. Titulli i Gjetjes:	Parregullsi gjatë vlerësimit të ofertave
Situata:	Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt “Suport, licenca dhe mirëmbajtje për pajisjet Hardëare”, në vlerësimin e ofertave vihet re që pika 2.3.3 e kriterëve të veçanta “ <i>Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë suportin ose autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për pajisjet dhe platformat (Switche, NFGË, platforme NAC, sistemi NMS, Akses Point, Sëitche Aksesit). Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij</i> ”, nuk përmbushet nga O.E. fitues, ku në dokumentet e ngarkuara nga O.E. në sistemin elektronik të APP, gjendej vetëm një autorizim nga Hewlet Packard me anë të emailit, ku dhe kjo e fundit nuk i mbulon të gjitha artikujt në specifikimet teknike.
Kriteri:	Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim për zhvillimin e objektivave të shoqërisë dhe përmbushjen e kontratës së prokurimit
Shkaku:	Vlerësim jo i saktë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	OST sh.a., të tregojë kujdes gjatë vlerësimit të ofertave dhe të marrë në konsideratë të gjithë kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara nëse janë ose jo në përputhje me dokumentacionin e sjellë nga O.E. pjesëmarrës.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi

Njësia e hartimit e specifikimeve teknike z.R. K., z. K. P. dhe z. M. M., dhe Komisioni i Vlerësimit të ofertave z. D. M., z. E. Xh. dhe z. D. Sh.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 2778/23 prot, datë 26.05.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e z. R. K., z. K. P., z. M. M., z. D. M., z. E. Xh. dhe z. D. Sh., të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Praktika e ndjekur është konform praktikave me të mira sipas standardeve të sigurisë së informacionit, vazhdimësisë së biznesit dhe rekomandimeve të ENTSO-E dhe AKSHI. Certifikimet nga prodhuesi në keto raste janë kërkesa të domosdoshme pasi nuk ka mënyrë tjetër të vertetojë që specialistet perkates kanë kompetencën që të punojnë me sistemet e OST sh.a. Gjithashtu në dijeni tone keto kërkesa janë minimaliste, nuk e ngushtojnë konkurrencën dhe janë të shumta kompanite në Shqipëri të cilat kanë specialiste të certifikuar për keto pajisje dhe sisteme.

Sa i perket qendrimin tuaj mbi Autorizim e Prodhuesit për Vmëare vSphere ju bejme me dije se nuk ka qene kerkese ne kete objekt prokurimi.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Disponueshmeria dhe qendrueshmeria pajisjeve dhe sistemeve duke blere shërbimin e suport në nivel hardware,

software dhe subscription për sa më sipër mund të kryhet dhe nga punonjës të cilët kanë certifikime për rrjetin ëireless dhe për pajisjet e sigurisë që jo domosdoshmërisht nga prodhuesit i pajisjeve në fjalë. Gjithashtu për sa i përket deklaratës që nuk keni kërkuar autorizim prodhuesi për Vmëare vSphere bini në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara pasi dhe Vmëare Vsphere përfshihet në kërkesën për autorizim prodhuesi.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

- “FV lexues aksesi dhe sisteme të tjera për zonat e sigurisë së lartë në AQ dhe njësi”

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) Lekë lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ FV lexues aksesi dhe sisteme të tjera për zonat e sigurisë së lartë në AQ dhe njësi ”		
1. Urdhër Prokurimi Nr.183, datë 04.08.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit E hapur e thjeshtuar	2. Njësia e Prokurimit z. N. T. z. M. C. z. M. M.	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike: z. N. T. z. M. C. z. M. M.
4. Fondi limit (pa tvsh) 1,800,000 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i shoqërisë	6. Data e hapjes së tenderit 12.12.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës “ S. ATS ” sh.p.k 1,656,000 “A” sh.p.k. 1,717,600 b) kualifikuar: “ S. ATS ” sh.p.k 1,656,000	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z. D. Sh. z. T. Q. z. D. M.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 1,656,000 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Datë 16.01.2023	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 144.000 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës z. N. T.	14. Fletë hyrja Shërbim	15. Afati i kontratës 10 ditë
16.Vlera e kontratës me TVSH 1,987,200 lekë		

Gjatë analizimi të kriterëve të vecanta të kualifikimi vihet re kriteri nr. 2.3.5 që citon:

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues, për të bere konfigurimet e nevojshme te mallrave objekt prokurimi, duhet te kete punonjësit si vijon:*

- *I(nje) specialist të certifikuar për sistemin e kontrollit të aksesit nga prodhuesi i sistemit.*
- *I(nje) specialist të certifikuar për sistemin e detektimit të zjarrit nga prodhuesi i sistemit.*
- *I(nje) teknik të pajisur me dëshmi kualifikimi per sistemin e zjarrit dhe per sistemin e akses-kontrollit.*

Operatori Ekonomik ofertues mund te disponoje punonjësën e mësipërm ne dy mënyra:

- Ne stafin e tij dhe per kete duhet te kete certifikimet/dëshminë e punonjësit, listepagesen e fundit e-sig dhe kontratën e punës.*
- Me ane te kontraktimit dhe per kete duhet te kete kontratën noteriale dhe certifikimet/dëshminë paktese.*

Sipas grupit të auditimit, duke u bazuar dhe tek vlera e kontratës, kriteri 2.3.5, certifikimet e kërkuara janë të tepërta, pasi kufizojnë konkurrencën dhe nuk janë në përputhje me objektin e kontratës dhe vlerën e kontratës. Procedura e hapur e thjeshtuar nuk duhet të ketë shumë kriterë, në mënyrë që të jetë e mundur përfshirja e biznesit të vogël dhe të mesëm.

14. Titulli i Gjetjes:	Parregullsi gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kritereve të vecanta
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “FV lexues aksesi dhe sisteme të tjera për zonat e sigurisë së lartë në AQ dhe njësi” , në analizimin e kritereve të vecanta të kualifikimi vihet re kriteri nr. 2.3.5, sipas grupit të auditimit, duke u bazuar dhe tek vlera e kontratës, certifikimet e kërkuara janë të tepërta, pasi kufizojnë konkurrencën dhe nuk janë në përputhje me objektin e kontratës dhe vlerën e kontratës. Procedura e hapur e thjeshtuar nuk duhet të ketë shumë kritere, në mënyrë që të jetë e mundur përfshirja e biznesit të vogël dhe të mesëm.
Kriteri:	Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Pengesë në zhvillimin e një gare dhe konkurrence të drejtë
Shkaku:	Vendosja e kritereve jo në proporcion me vlerën e kontratës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	OST sh.a., gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të mirëmbajtjes, të krijojë kushte me gjithëpërfshirëse, pasi vendosja e kritereve të cilët kërkojnë certifikimin e vetëm të prodhuesve do të pengojnë zhvillimin e një konkurrence të drejtë.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi

Njësia e Prokurimit, z. N. T., z. M. C. dhe z. M. M. dhe Njësia e hartimit e specifikimeve teknike z. M. C., z. L. K. dhe z. M. M.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 222/9 prot, datë 18.07.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e z. N. T., z. M. C., z. L. K. dhe z. M. M., të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Kriteret e kërkuara për këto procedure janë në nivel minimal krahasuar me ambientet ku është kërkuar instalimi dhe plotësisht në përputhje me objektin e tender bazuar në nenin 36 “Specifikimet Teknike” dhe VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu kriteret kanë qenë gjithëpërfshirëse pasi nuk kanë patur asnjë marke apo brand të referuar dhe nuk e pengojnë zhvillimin e konkurrencës në gare për me tepër në dijeni tone ka me dhjetra kompani në Shqipëri të cilët kanë specialist të certifikuar në këto fusha.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Vendosja e kritereve gjithëpërfshirëse shërben edhe për zhvillimin e procedurave në të ardhmen. specialist të certifikuar për sistemin e kontrollit të aksesit nga prodhuesi i sistemit, specialist të certifikuar për sistemin e detektimit të zjarrit nga prodhuesi i sistemit, teknik të pajisur me dëshmi kualifikimi për sistemin e zjarrit dhe për sistemin e akses-kontrollit do të bëjnë të mundur që gara të fitohet gjithmonë nga i njëjti O.E. dhe do të krijojë probleme të tjera në të ardhmen dhe në lidhje me përcaktimin e fondit limit.

Kriteri për specialist të certifikuar, të cojnë drejt një marke ose brandi specifik.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

- “Upgrade dhe migrimi i shërbimeve të e-mail de virtualizimi”

Përshkrimi i procedurës

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën 8,500,000 Lekë lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Upgrade dhe migrimi i shërbimeve të e-mail de virtualizimi ”		
1. Urdhër Prokurimi		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit E hapur e thjeshtuar	2. Njësia e Prokurimit z. N. T. z. G.B. z. M. M.	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike: z. N. T. z. G. B. z. M. M.
4. Fondi limit (pa tvsh) 8,500,000 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i shoqërisë	6. Data e hapjes së tenderit 12.12.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës “I. Systems” sh.p.k 8,160,000 “C.C.S” sh.p.k. 8,450,000 b) kualifikuar: “I. Systems” sh.p.k 8,160,000	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z. D. Sh. z. E. Xh. z. D. M.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 8,160,000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Datë 15.02.2023	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 340.000 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës z. N. T.	14. Fletë hyrja Shërbim	15. Afati i kontratës 1 muaj
16.Vlera e kontratës me TVSH 9,792,000 lekë		

Auditimi i zbatimit të kontratave

- Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 968/14 prot datë 11.05.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor OST sh.a., të përfaqësuar nga Administratori z. S. D. dhe Operatorit Ekonomik “G.A.C.” ShPK, me përfaqësues znj. A. P., me licencë profesionale MK. 7351/4. Vlera e kontratës është 138,991,200 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 7 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 4816/16, datë 08.09.2021, është lidhur kontrata me BOE “H..” SHPK & “E.....-G” ShPK & “T.....” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2720/6 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 636,000 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas Urdhrit të Administratorit të OST sh.a. me nr. 302, datë 15.11.2021, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi grupi i kolaudimit me përbërje K. B., R. M. dhe R. K.. Në dosjen e zbatimit nuk administrohen licencat profesionale të anëtarëve të grupit të kolaudimit. Mungesa e licencave profesionale është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 12, sipas të cilit “...Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik,

vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë...”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i OST sh.a., z. S. D..

Ky grup pune ka hartuar edhe Certifikatën për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit.

Projektpreventivi

- Projekti i zbatimit dhe preventivi final i këtij objekti është hartuar nga sipërmarrësi i punimeve, në zbatim të kontratës së sipërmarrjes (preventivi).

- Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i OST sh.a., z. S. D..

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 08.09.2021 dhe kanë përfunduar me datë 28.10.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë”				
14.Lidhja e kontratës Nr. 968/14 prot datë 11.05.2021	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 138,991,200 lekë OE fitues “G.A.C” ShPK		16.Likuiduar deri dt 21.12.2021 138,991,200 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 138,991,200 lekë -Vlera pa tvsh 115,826,000 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 210 ditë , Zbatuar 50 ditë. Fillimi punimeve: 08.09.2021 Përfundimi punimeve : 28.10.2021		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “H..” SHPK & “E.....-G” ShPK & “T.....” SHPK	Licenca Nr: MK 2720/6	Kontrata me nr 4816/16, datë 08.09.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve K. B., R. M. dhe R. K.	Licenca Nr: MK	Urdhri nr. 302, datë 15.11.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 15.12.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim Datë 15.12.2021		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë(për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **802,400 lekë pa tvsh**.

16. Titulli i Gjetjes 1:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë”, nga zbatuesi i punimeve OE “G...” SHPK, për zërin e punimeve 8.
---------------------------------	--

Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërin e punës “Trajnim i inxhinierëve të SMR për parametrizimin dhe aksesimin e pajisjeve (sipas specifikimeve teknike)”, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1292/13 prot datë 12.04.2021. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 968/14 prot datë 11.05.2021. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas Urdhrit të Administratorit të OST sh.a. me nr. 302, datë 15.11.2021.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Selenicë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I ulët.
Rekomandime:	Nga OST sh.a. të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 802,400 lekë pa tvsh nga OE “G...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 968/14 prot datë 11.05.2021 me objekt “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmblodhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 802,400 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. G. P. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. K. B., R. M. dhe R. K., me detyrë kolaudatorë të punimeve të përfunduara;

- **Rikonstrukcion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel**

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1292/13 prot datë 12.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor OST sh.a., të përfaqësuar nga Administratori z. S. D. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “A & E” SHPK, me përfaqësues z. A. B., me licencë profesionale NZ 7054 & “K...” ShPK, me përfaqësues znj. E. K.. Në dosje administrohet një aktmarrëveshje me nr. 3570 rep, nr. 706 kol., datë 24.11.2021, e cila ka ndryshuar kontratën e bashkëpunimit të antarëve të BOE, sipas të cilës OE “K...” ShPK, heq dorë nga pjesa takuese e

kontratës së zbatimit të punimeve. Në dosje nuk administrohet asnjë dokument për miratimin nga Investitori për vazhdimin e punimeve të anëtarit të mbetur në BOE. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 27 të kontratës, sipas të cilit “27.1 *Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.*

27.2 *Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.*

27.3 *Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.” dhe duhet të jetë në konsideratën e strukturave të OST-së në dhënien e Formularit të Vlerësimit pas përfundimit të garancisë së punimeve.*

Vlera e kontratës është 49,308,012 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1970 prot, datë 20.04.2021, është lidhur kontrata me BOE “A..... 4” SHPK & “I.....” ShPK & “K.....-05” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2185/4 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 786,498 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas Urdhrit të Brendshëm të Administratorit të OST sh.a. me nr. 195 prot., datë 25.08.2022, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi grupi i kolaudimit me përbërje K. G., S. H., R. Z.. Në dosjen e zbatimit nuk administrohen licencat profesionale të antarëve të grupit të kolaudimit. Mungesa e licencave profesionale për kolaudim është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 12, sipas të cilit “...*Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë....*”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i OST sh.a., z. S. D..

Ky grup pune ka hartuar edhe Certifikatën për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit.

Projektpreventivi

- Projekti i zbatimit dhe preventivi final i këtij objekti është hartuar nga sipërmarrësi i punimeve, në zbatim të kontratës së sipërmarrjes (preventivit).

- Pas verifikimit të preventivit, rezultoi që për këtë objekt, duhet Deklaratë Paraprake Punimesh, e cila nuk administrohet në dosje. Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 7, “Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh”, sipas të cilit “*Pa përjashtuar detyrimin e respektimit të dispozitave ligjore të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi për veprimtaritë ndërtimore, përfshirë, në mënyrë të veçantë, sa i përket qëndrueshmërisë antisizmike, mbrojtjes kundër zjarrit, ruajtjes së sigurisë dhe higjienës shëndetësore, punimet e mëposhtme kryhen pa pajisjen me leje ndërtimi, pas njoftimit të deklaratës paraprake të fillimit të punimeve pranë autoritetit kompetent të planifikimit dhe zhvillimit: i) Punime të jashtme, si:*

.... “*...punime riparimi, zëvendësimi dhe mirëmbajtje e rrjeteve të infrastrukturës publike, që nuk prekin sistemin konstruktiv të tyre, nuk ndryshojnë përdorimin dhe përmasat e infrastrukturës si dhe kushtet e zhvillimit në zonën përreth;*” dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e OST sh.a. z. S. D., mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktorin e punimeve.

- Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i OST sh.a., z. S. D.

- Nga shqyrtimi i preventivit të objektit, rezultoi se është preventivuar edhe zëri “Ngritje kantieri (rrethim i përkohshëm kolona + rrjet teli)”. Ky zë pune është i detajuar për rrethimin e përkohshëm, tabelat informuese dhe furnizimet për zyrat. Nisur nga UKM Nr.2, date 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika B.B, sipas të cilës “... *Shpenzimet e pergjithshme dhe fitimi, qe perfshihen ne cmimet njesore te zerave te punes, per punimet e ndertimit dhe punimet teknologjike llogariten me perqindje mbi shpenzimet e drejtperdrejta, ndersa per punimet e montimit te pajisjeve dhe makinerive, me perqindje mbi pagat baze e shtese te fuqise punetore, qe merret me punimet e montimit.*

SHPENZIME TE PERGJITHSHME

Ne shpenzimet e pergjithshme perfshihen:

.....

3. *Shpenzimet per masat e sigurimit teknik, rrethimet e perkohshme gjate ndertimit ne lartesi, skelat, makinerite, tabelat sinjalizuese etj.. per mbrojtjen ne pune si trajtimi me veshmbathje, ushqimore, antidode, ndihme e shpejte etj.*

.....

6. *Shpenzimet per marrjen me qera te ndertesave te ndryshme dhe per nderime te perkohshme per zyra, magazina, nyje llaç-betoni e hekur-beton etj., rruget e vinç-kullave, ndriçimi e territorit, linjat e furnizimit me energji elektrike, telefoni, ujesjelles, kanalizime si dhe sheshe e rruge, brenda e jashte sheshit te ndertimit etj.”. Sa sipër, ky zë pune nuk duhej preventivuar.*

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 22.11.2021 dhe kanë përfunduar me datë 11.08.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”			
14.Lidhja e kontratës Nr. 1292/13 prot datë 12.04.2021	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 49,308,012 lekë BOE fitues “A & E” SHPK & “K...” ShPK		16.Likuiduar deri dt 14.11.2022 46,842,209 lekë
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 49,308,012 lekë -Vlera pa tvsh 41,090,010 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 365 ditë , Zbatuar 263 ditë. Fillimi punimeve: 22.11.2021 Perfundimi punimeve : 11.08.2022		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “A..... 4” SHPK & “I.....” ShPK & “K....-05” SHPK	Licenca Nr: MK 2185/4	Kontrata me nr 1970 prot, datë 20.04.2021	Likuiduar lekë
			Pa likuiduar

21. Kolaudatori i punimeve K. G., S. H., R. Z.	Licenca Nr: MK	Urdhrit nr. 195 prot., datë 25.08.2022	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22. Akt Kolaudimi Datë 24.10.2022	23. Akt i marrjes në dorëzim Datë 24.10.2022		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **237,600 lekë pa tvsh**.

17. Titulli i Gjetjes:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”, nga zbatuesi i punimeve BOE “A&E” SHPK & “K....” SHPK, për zërin e punimeve 2.5.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Gërmim dheu me ekskavator 0.25 m3, tokë e zakonshme, kategoria III, për rrugët, t=20cm, me shkarkim në mjet”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1292/13 prot datë 12.04.2021. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1970 prot, datë 20.04.2021. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas Urdhrit me nr. 195 prot., datë 25.08.2022.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e OST sh.a.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I ulët.
Rekomandime:	Nga OST sh.a. të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 237,600 lekë pa tvsh nga BOE “A & E” SHPK & “K...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1246 prot datë 27.04.2021 me objekt “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 237,600 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A. E. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. K. G., S. H., R. Z. me detyrë kolaudatorë të punimeve të përfunduara;

II.2.7 Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.)

Në zbatim të pikës 7 të Programit të Auditimit nr. 222/1 Prot., datë 16.03.2023, “Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.)” u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).

OST sh.a. ka zhvilluar 49 procedura me vlerë të vogël me fond limit në total 18,436,840 lekë pa TVSH.

Në qëllim të përmbushjes së pikës së mësipërme të programit, në bazë të riskut dhe kriterëve të përzgjedhjes, u morën në shqyrtim procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, si më poshtë:

Objekti	Fondi limit	Afati	Operatori Ekonomik	Oferta
Riparimi dhe mirëmbajtja e sistemit të Kondicionimit dhe Aspirimit në Godinën Qendrore të OST sh.a., për një periudhë 6-mujore	947,700.00	07.06.2022	(I.B.S.)	900,000.00
Shërbim DDD dhe gjelbërimi i godinës Qendrore të OST sh.a., për një periudhë 1-vjeçare	817,243.00	15.04.2022	A. B.	698,200.00
Bojatisje e ambienteve të brendshme të Godinës së OST sh.a	799,900.00	02.09.2022	(I.B.S.)	680,000.00
Sherbim me uje te pijshëm me aparat për një periudhë 1-vjeçare	794,000.00	01.03.2022	L. INVEST	794,000.00
Riparim, zëvendësim dhe zgjerim te sistemit ekzistues CCTV	778,500.00	26.10.2022	S. ATS	760,000.00
Furnizim vendosje dy UPS (inverter)	770,000.00	30.12.2022	S. CO	740,000.00
Furnizim me uje sanitar me bot	750,000.00	01.07.2022	P. S...	720,000.00

Riparimi dhe mirëmbajtja e sistemit të Kondicionimit dhe Aspirimit në Godinën Qendrore të OST sh.a., për një periudhë 6-mujore

Me shkresën e datës 31.05.2022 znj. J. M., me detyrë Drejtor i DSHM ka kryer kërkesë për riparim dhe mirëmbajtje të sistemit të Kondicionimit dhe Aspirimit në Godinën Qendrore të OST sh.a. për një periudhë 6-mujore drejtuar Administratorit të OST sh.a. z. S. D., me nr. 3356 prot. Me procesverbalin e datës 03.06.2022, është përlllogaritur fondi limit nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla duke marrë parasysh 3 oferta të tregut përkatësisht:

“E.....” me çmim 942.300 lekë pa tvsh

“K..... Service” me çmim 988.550 lekë pa tvsh

“K..... teknika” me çmim 912.300 lekë pa tvsh.

Duke llogaritur vlerën mesatare të 3 operatorëve ekonomikë mesatarja e ofertave është **947.700** lekë pa tvsh.

Nga procesverbali i anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlera të vogla u konstatua se:

- Oferta e përgatitur nga operatori ekonomik "S.G. K." është mbi fondin limit të parashikuar nga Autoriteti Kontraktor i nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit. Sa më sipër komisioni i prokurimit me vlerë të vogël vendosi të refuzojë ofertën e operatorit ekonomik "S. G. K."
- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka bërë verifikimin e Ektraktit të QKB-se dhe konstatoi se: Nuk përfshihet në objektin e aktivitetit, fusha objekt prokurimi. Sa më sipër komisioni i prokurimit me vlerë të vogël vendosi të refuzojë ofertën e operatorit ekonomik "S. R."
- Operatorët ekonomik "S.....-Klima", "C.....casa" dhe "X.... Systems" njoftuan nepermjet SPE Autoritetin Kontraktor për tërheqjen nga realizimi i procedurës së prokurimit.
- Si rrjedhojë nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimeve me vlera të vogla mbështetur në kriteret e kualifikimit kërkuar sipas ftesës për ofertë vendosi të konsiderojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik "S.... Group Klima", "S. Rr.", "S.....Klima", "C.....casa" dhe "X.... Systems", oferta jo të vlefshme.

Ndërsa oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "I. B. S.", është në përputhje me kriteret e kualifikimit të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në ftesën për ofertë.

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit me Vlerë të vogël i përbërë nga z.E. A., z.E. X. dhe znj.A. N. vendosi të shpallë fitues operatorin ekonomik "I. B. S.", me vlerë të ofertës pa TVSH prej 900 000 (nëntëqind mijë) lekë.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit së mësipërme u konstatua:

Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga OST sh.a mungon procesverbali i kolaudimit dhe marrjes në dorëzim.

Shërbim DDD dhe gjelbërimi i godinës Qendrore të OST sh.a., për një periudhë 1-vjeçare

Me shkresën e datës 06.04.2022 znj. J. M., me detyrë Drejtor i DSHM ka kryer kërkesë për shërbim DDD dhe gjelbërimi i godinës Qendrore të OST sh.a., për një periudhë 1-vjeçare drejtuar Administratorit të OST sh.a. z. S. D., me nr. 2194 prot.

Me procesverbalin e datës 25.02.2022, është përlllogaritur fondi limit nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla duke marrë parasysh 3 oferta të tregut përkatësisht:

"G...." me çmim 817.730 lekë pa tvsh

"A..P....." me çmim 838.050 lekë pa tvsh

"E... Cl....." me çmim 795.950 lekë pa tvsh.

Duke llogaritur vlerën mesatare të 3 operatorëve ekonomikë mesatarja e ofertave është **817.243** lekë pa tvsh.

Nga procesverbali i anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlera të vogla u konstatua se:

- Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "V. C." është mbi fondin limit të parashikuar nga Autoriteti Kontraktor i nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit.
- Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "S....." është mbi fondin limit të parashikuar nga Autoriteti Kontraktor i nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit.
- Mbështetur dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.5, datë 25.06.2021, Pika 15 "Refuzimi i ofertave", germa c ku thuhet: Anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël do të refuzojnë automatikisht ofertat e të çileve është ulur me shumë se 50% e fondit limit të përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor i nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël vendosi të refuzojë ofertën e operatorit ekonomik “G. Albania”.

- Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “F. D.” është mbi fondin limit të parashikuar nga Autoriteti Kontraktor i nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit.

- Mbështetur dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.5, datë 25.06.2021, Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, pas verifikimit të ofertave të paraqitura shpalli fitues operatorin ekonomik “E. M.” i renditur i pari në klasifikim me një vlerë të ofertës prej 415 000 (katërqind e pesëmbëdhjetë mijë) leke. Operatori ekonomik “E. M.”, nuk u paraqit dhe nuk njoftoi nepermjet SPE Autoritetin Kontraktor për arsyet e mosrealizimit të procedurës së prokurimit.

- Mbështetur dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.5, datë 25.06.2021, Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, shpalli fitues operatorin ekonomik “M. BA” i renditur i dyti në klasifikim me një vlerë të ofertës prej 438 000 (katërqind e tridhjetë e tetë mijë) leke. Operatori ekonomik “M. BA” njoftoi nepermjet SPE Autoritetin Kontraktor për tërheqjen nga realizimi i procedurës së prokurimit.

- Për ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “H. E. Group” njoftoi nepermjet SPE Autoritetin Kontraktor për tërheqjen nga realizimi i procedurës së prokurimit.

- Operatori ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” njoftoi nepermjet SPE Autoritetin Kontraktor për tërheqjen nga realizimi i procedurës së prokurimit.

- Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël shpalli fitues nepermjet SPE operatorin ekonomik “A. B.” i renditur i pesti në klasifikim me një vlerë të ofertës prej 698 200 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind). Operatori ekonomik “A. B.”, u paraqit brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë së bashku me dokumentet e kërkuara sipas ftesës për ofertë. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi bëri verifikimin e dokumentave të paraqitura konstatoi se dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik “A. B.” janë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor kërkuar sipas ftesës për ofertë.

Si rrjedhojë nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimeve me Vlerë të Vogël mbështetur në kriteret e kualifikimit kërkuar sipas ftesës për ofertë vendosi të konsiderojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik “V. C.”, “S.....”, “G.... Albania”, “F. D.”, “E. M.”, “M. BA”, “H... E.. Group” dhe “Akademia e Shëndetit Publik” oferta jo të vlefshme.

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit me Vlerë të vogël i përbërë z.E. A., z.E. X. dhe znj.A. N. vendosi të shpallë fitues operatorin ekonomik “A.B.”, me vlerë të ofertës pa TVSH prej 698 200 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind) lekë.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit së mësipërme u konstatua:

Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga OST sh.a mungon procesverbali i kolaudimit dhe marrjes në dorëzim.

Bojatisje e ambienteve të brendshme të Godinës së OST sh.a

Me shkresën e datës 08.08.2022 znj. J. M., me detyrë Drejtor i DSHM ka kryer kërkesë për bojatisje të ambienteve të brendshme të Godinës së OST Administratorit të OST sh.a. z.S. D., me nr. 4919 prot.

Nga procesverbali i anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël u konstatua se:

- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, konstatoi se, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “O. H.” është mbi fondin limit të parashikuar nga Autoriteti Kontraktor i nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit.

- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, konstatoi se, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "SAM-ARS 2016" është mbi fondin limit të parashikuar nga Autoriteti Kontraktor i nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit.
- Mbështetur dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.5 datë 25.06.2021, pika 15 gërma b) "Refuzimi i ofertave". Oferta e OE "S. A." refuzohet për arsye se është shpallur fitues në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt " Blerje Mikro Filtra për makineritë e trajtimit të vajit të transformatorëve " zhvilluar më datë 13.05.2022. Pas dorëzimit të dokumentave në protokollin e OST sh.a..Nuk keni realizuar procedurën e prokurimit dhe nuk njoftuar Autoritetin Kontraktor për mosrealizimin e procedurës së Prokurimit.
- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, konstatoi se, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "2-MJ" është mbi fondin limit të parashikuar nga Autoriteti Kontraktor i nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit.
- Operatorët ekonomik "M.-BA", "Alb K....", "4 A C.....", "AGFA", "Sh. M.", "L. Xh." dhe "A. B." njoftuan nepermjet SPE Autoritetin Kontraktor për tërheqjen nga realizimi i procedurës së prokurimit.
- Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla mbështetur në kriteret e kualifikimit kërkuar sipas ftesës për ofertë vendosi të konsiderojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik "O.H.", "SAM-ARS 2016", "S. A.", "2-MJ", "M...-BA", "Alb-K....", "A. B.", "4A C.....", "AGFA", "Sh.M." dhe "L. Xh.", oferta jo të vlefshme. Ndërsa oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "I. B. S. ", është në përputhje me kriteret e kualifikimit të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në ftesën për ofertë. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit me Vlerë të vogël vendosi të shpallë fitues operatorin ekonomik "I. B. S. ", me vlerë të ofertës pa TVSH prej 680 000 (gjashtëqind e tetëdhjetemije) lekë pa TVSH.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit së mësipërme u konstatua:

- Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga OST sh.a mungon procesverbali i kolaudimit dhe marrjes në dorëzim.
- Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga OST sh.a mungon procesverbali për përlllogaritjen e fondin limit.

Shërbim me ujë të pijshëm me aparat për një periudhë 1-vjeçare

Me shkresën e datës 23.02.2022 znj. J. M., me detyrë Drejtor i DSHM ka kryer kërkesë për sigurimin me ujë të pijshëm për një periudhë një vjeçare drejtuar Administratorit të OST sh.a. z.S. D., me nr. 1277 prot.

Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël gjykoi që për përlllogaritjen e fondit limit të nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit të merren për bazë çmimet e kontratës së mëparshme me fond limit 794,000 lekë.

Konstatohet që L. INVEST ka dhënë ofertën më të ulët, ndërkohë OE "A. XH." ka dhënë ofertë e cila tejkalon fondin limit me vlerën 999,000 lekë.

Për sa më sipër, komisioni i blerjeve me vlerë të vogël i përbërë nga z.E. A., z.E. X. dhe znj.A. N. vendosi të shpallë fitues OE "L. I." për procedurën e prokurimit me objekt "Shërbim me ujë të pijshëm me aparat për një periudhë 1-vjeçare".

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të mësipërme u konstatua:

Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga OST sh.a mungon procesverbali i kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të shërbimit si dhe procesverbali mbi ndërrimin e pajisjeve 1 herë në 6 muaj sipas kushteve të kontratës.

5. Riparim, zëvendësim dhe zgjerim të sistemit ekzistues CCTV

Me shkresën e datës 17.10.2022 z. D. Sh., me detyrë Drejtor i DSHTI ka kryer kërkesë për riparim, zëvendësim dhe zgjerim të sistemit ekzistues CCTV Administratorit të OST sh.a. z.S. D., me nr. 5434/2 prot.

Me procesverbalin e datës 21.10.2022, është përlllogaritur fondi limit nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla duke marrë parasysh 3 oferta të tregut përkatësisht:

“S..” me çmim 761.400 lekë pa tvsh

“T. Solutions” me çmim 799.800 lekë pa tvsh

“Pc S...” me çmim 774.300 lekë pa tvsh.

Duke llogaritur vlerën mesatare të 3 operatorëve ekonomikë mesatarja e ofertave është **778.500** lekë pa tvsh.

Nga procesverbali i anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlera të vogla u konstatua se:

- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël shpalli fitues operatorin ekonomik “X.... Systems” i renditur i pari ne klasifikim me një vlerë të ofertës prej 420 000 (katërqind e njetetemije) leke. Operatori ekonomik “X.... Sytems” njoftoi nepermjet SPE Autoritetin Kontraktor per tërheqjen nga realizimi i procedurës se prokurimit.

- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël shpalli fitues operatorin ekonomik “A. D.” i renditur i dyti ne klasifikim me një vlerë të ofertës prej 450 000 (katërqind e pesedhjetemije) lekë. Operatori ekonomik “A. D.” njoftoi nëpërmjet SPE Autoritetin Kontraktor për tërheqjen nga realizimi i procedurës së prokurimit.

- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, shpalli fitues operatorin ekonomik “O. T.” i renditur i treti ne klasifikim me nje vlere të ofertës prej 666 667 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtate) lekë. Operatori ekonomik “Oni Trade” njoftoi nepermjet SPE Autoritetin Kontraktor per tërheqjen nga realizimi i procedurës se prokurimit.

- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, shpalli fitues operatorin ekonomik “S..-2022” i renditur i katërti ne klasifikim me nje vlere te ofertës prej 716 667 (shtatëqind e gjashtembdhjetemije e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtate) leke. Operatori ekonomik “Start-2022” njoftoi nepermjet SPE Autoritetin Kontraktor per tërheqjen nga realizimi i procedurës se prokurimit.

- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël shpalli fitues operatorin ekonomik “J... Group” i renditur i pesti ne klasifikim me nje vlere te ofertës prej 750 000 (shtatëqind e pesedhjetemije) leke. Operatori ekonomik “J... Group” njoftoi nepermjet SPE Autoritetin Kontraktor per tërheqjen nga realizimi i procedurës se prokurimit.

- Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi beri verifikimin e dokumentave të paraqitura konstatoi se dokumentar e paraqitura nga operatori ekonomik “S.... ATS” jane ne perputhje me kerkesat e Autoritetit Kontraktor kerkuar sipas ftesës per oferte.

Sa me sipër Komisioni i Prokurimit me Vlerë të vogël i përbërë nga z.E. A., z.E. X. dhe znj.A. N. vendosi të shpallë fitues operatorin ekonomik “S.... ATS”, me vlerë të ofertës pa TVSH prej 760 000 (shtatëqind e gjashtedhjetemije) lekë.

Datë 16.11.2022 mbahet akti kolaudimit dhe marrjes ne dorëzim të shërbimeve, në zbatim të UP Nr.59 date 21/ 10/2022 me objekt Riparim, zëvendësim dhe zgjerim të sistemit ekzistues CCTV.

Grupi i kolaudimit dhe i marrjes në dorëzim i përbërë nga L. K., K. P. dhe M. M. ka bërë verifikim të mallrave dhe shërbimeve dhe kanë dalë në konkluzionin se mallrat dhe shërbimet e pranuar rezultojnë në respektim me specifikimet teknike.

Furnizim vendosje dy UPS (inverter)

Me shkresën e datës 27.12.2022 z. D. Sh., me detyrë Drejtor i DSHTI ka kryer kërkesë për furnizim vendosje dy UPS (inverter) Administratorit të OST sh.a. z.S. D., me nr. 7777 prot.

Me procesverbalin e datës 21.10.2022, është përlllogaritur fondi limit nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla duke marrë parasysh 3 oferta të tregut përkatësisht:

“S...” me çmim 762.000 lekë pa tvsh

“I.....” me çmim 765.000 lekë pa tvsh

“T.... S.” me çmim 783.000 lekë pa tvsh.

Duke llogaritur vlerën mesatare të 3 operatorëve ekonomikë mesatarja e ofertave është **770.000** lekë pa tvsh.

Nga procesverbali i anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlera të vogla u konstatua se:

- Mbështetur dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 5 date 25.06.2021 “Per përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. Pika 15 “Refuzimi i ofertave”, germa c) ku thuhet: Anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël refuzojnë automatikisht operatorët ekonomikë, oferta e të cilëve është ulur me shumë se 50% e fondit limit të përlllogaritur. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “O. H.”, është ulur me shumë se 50% e fondit limit. Si rrjedhojë Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël vendosi të refuzojë ofertën e operatorit ekonomik “O. H.”.

- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, konstatoi se, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “E.. Group” është mbi fondin limit të parashikuar nga Autoriteti Kontraktor i nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit. Sa më sipër komisioni i prokurimit me vlerë të vogël vendosi të refuzojë ofertën e operatorit ekonomik “E.. Group”.

- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, konstatoi se, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “B.....” është mbi fondin limit të parashikuar nga Autoriteti Kontraktor i nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit. Sa më sipër komisioni i prokurimit me vlerë të vogël vendosi të refuzojë ofertën e operatorit ekonomik “B.....”.

- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, konstatoi se, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “PC S.....” është mbi fondin limit të parashikuar nga Autoriteti Kontraktor i nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit. Sa më sipër komisioni i prokurimit me vlerë të vogël vendosi të refuzojë ofertën e operatorit ekonomik “PC S....”.

- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, konstatoi se, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “J..... Group” është mbi fondin limit të parashikuar nga Autoriteti Kontraktor i nevojshëm për realizimin e procedurës së prokurimit. Sa më sipër komisioni i prokurimit me vlerë të vogël vendosi të refuzojë ofertën e operatorit ekonomik “J..... Group”.

- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, shpalli fitues operatorin ekonomik “IBS” i renditur i pari në klasifikim me një vlerë të ofertës prej 689 000 (gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë) leke. Operatori ekonomik “IBS” njoftoi nepermjet SPE Autoritetin Kontraktor për tërheqjen nga realizimi i procedurës së prokurimit.

- Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, shpalli fitues operatorin ekonomik “A. D.” i renditur i dyti në klasifikim me një vlerë të ofertës prej 725 000 (shtatëqind e njëzetë e pesë mijë) leke.

Operatori ekonomik "A. D." njoftoi nepermjet SPE Autoritetin Kontraktor per tërheqjen nga realizimi i procedurës se prokurimit.

- Mbështetur dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.5, datë 25.06.2021. Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, shpalli fitues operatorin ekonomik "F. Electronic" i renditur i treti ne klasifikim me nje vlere te ofertës prej 735 000 (shtatëqind e tridhjetë e pesëmijë) leke. Operatori ekonomik "F. Electronic" njoftoi nepermjet SPE Autoritetin Kontraktor per tërheqjen nga realizimi i procedurës se prokurimit.

-Operatori ekonomik "S.... CO", u paraqit brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë së bashku me dokumentet e kërkuara sipas ftesës për ofertë.

Sa me sipër Komisioni i Prokurimit me Vlerë të vogël i përbërë nga z.E. A., z.E. X. dhe znj.A. N. vendosi të shpallë fitues operatorin ekonomik "S.... CO", me vlerë të ofertës pa TVSH prej 740 000 (shtatëqind e dyzetmijë) lekë.

Datë 18.01.2023 mbahet akti kolaudimit dhe marrjes ne dorëzim te shërbimeve, në zbatim të UP Nr.74 date 29.01.2022 me objekt furnizim vendosje dy UPS (inverter).

Grupi i kolaudimit dhe i marrjes në dorëzim i përbërë nga L. K., K. P. dhe E. Xh. ka bërë verifikim të mallrave dhe shërbimeve dhe kanë dalë në konkluzionin se mallrat dhe shërbimet e pranuar rezultojnë në respektim me specifikimet teknike.

Furnizim me uje sanitar me bot

Me shkresën e datës 03.06.2022 znj. J. M., me detyrë Drejtor i DSHM ka kryer kërkesë për furnizim me uje sanitar me bot Administratorit të OST sh.a. z.S. D., me nr. 3469 prot.

Me procesverbalin e datës 29.06.2022, është përlllogaritur fondi limit nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla duke marrë parasysh 3 oferta të tregut përkatësisht:

"E....." me çmim 742.500 lekë pa tvsh

"T..." me çmim 775.000 lekë pa tvsh

"P... S..." me çmim 732.500 lekë pa tvsh.

Duke llogaritur vlerën mesatare të 3 operatorëve ekonomikë mesatarja e ofertave është **750.000** lekë pa tvsh.

Nga procesverbali i anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlera të vogla u konstatua se:

Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla mbështetur në kriteret e kualifikimit kërkuar sipas ftesës për ofertë vendosi te konsiderojë ofertën e përgatitur nga operatori ekonomik "P.S.", oferta të vlefshme. Sa me sipër Komisioni i Prokurimit me Vlerë të vogël i përbërë nga z.E. A., z.E. X. dhe znj.A. N. vendosi të shpallë fitues operatorin ekonomik "P.. S..", me vlerë të ofertës pa TVSH prej 720 000 (shtatëqind e njezetemije) lekë.

OE "P.S." është ofertuesi i vetëm.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit së mësipërme u konstatua:

Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga OST sh.a mungon procesverbali i kolaudimit dhe marrjes në dorëzim.

Për sa më sipër, nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, përpos gjetjeve të cituara më sipër, disa nga procedurat e prokurimit janë zhvilluar muajin e fundit të vitit, që përbëjnë risk mbi mënyrën e përdorimit të fondeve si dhe disa nga procedurat e tjera të cilat kanë objekt të ngjashëm me njëra tjetrën por që janë zhvilluar të ndara, duke bërë të mundur copëzimin e fondit dhe jo përdorimin e procedurave të prokurimit me vlerë të lartë.

18. Titulli i Gjetjes:	Parregullsi në zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël
Situata:	Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, disa nga procedurat e prokurimit janë zhvilluar muajin e fundit të vitit, që përbëjnë risk mbi mënyrën e përdorimit të fondeve si dhe disa nga procedurat e tjera të cilat kanë objekt të ngjashëm me njëra tjetrën por që janë zhvilluar të ndara, duke bërë të mundur copëzimin e fondit dhe jo përdorimin e procedurave të prokurimit me vlerë të lartë.
Kriteri:	Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 34 pika 2, me ndryshimet vijuese të tij,
Ndikimi/Efekti:	Ndikimi në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e efijencës në përdorimin e këtyre fondeve.
Shkaku:	Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	AK të marrë masa për trajnimin e punonjësve që kryejnë procedurat e prokurimit, duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve të brendshme për menaxhimin e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomikitet.

II.2.8 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar

Në zbatim të pikës 8 të Programit të Auditimit nr. 222/1 Prot., datë 16.03.2023, i ndryshuar. “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit*” u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).

Objektivi i këtij akt konstatimi është:

Për vlerësim, nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaria dhe kontrolli kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare të kenë mundur shërbime shëndetësore efektive dhe eficiente duke i adresuar drejt risqet potenciale për të dhënë garanci të mjaftueshme në realizimin e misionit dhe objektivave të vendosura nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

Në zbatim të pikës së mësipërme u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Rregullorja e brendshme.
- Pyetëtori i vlerësimit të performancës së OST sh.a.
- Deklarata e misionit të OST sh.a
- Struktura organizative e OST sh.a
- Raportet e auditimit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm u konstatua:

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në QKUM, grupi auditues kreu verifikimet mbi implementimin dhe plotësimin e kërkesave mbi funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale dhe realizimin e objektivave të vendosura për komponentët e mëposhtëm:

- *Mjedisin e kontrollit*
- *Menaxhimin e riskut*
- *Aktivitetet e kontrollit*
- *Informimin dhe komunikimin*
- *Monitorimin*

Mjedisi i Kontrollit

Në lidhje me strategjinë e cila përmban objektivat strategjike e shoqërisë, është miratuar Programi i zhvillimit ekonomik për vitin 2022 dhe parashikimi për dy vite në vazhdim miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin Nr.1 datë 31/01/2022 “Për miratimin e programit të zhvillimit ekonomik të OST sh.a. për vitin 2022” dhe Asambleja e Përgjithshme;

Në lidhje me plan veprimet e miratuara për arritjen e qëllimeve strategjike, që përmbajnë veprime, afate, dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar janë të përcaktuara në dokumentin “Detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës” si dhe në lidhje me informimin e menaxherët/nëpunësit/punonjësit e njësisë publike në lidhje me përmbajtjen e deklaratës së misionit, objektivave dhe të strategjisë, çdo nivel drejtues i shoqërisë, informohet në kohë reale mbi të gjitha materialet të cilat kanë në përmbajtjen e tyre elemente të objektivave dhe strategjive të shoqërisë. Materialet respektive, krahas informimit shkresor dhe/ose elektronik, publikohen dhe në rubrikat përkatëse të database të rrjetit të brendshëm të shoqërisë.

Në lidhje me etikën, rregullore/udhëzime të brendshëm në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues mbi etikën, konfliktin e interesit, marrëdhëniet midis menaxhereve, marrëdhëniet me te tretet, gjejnë gjejnë trajtim në disa akte si më poshtë:

1. Statuti i Shoqërisë miratuar me Vendimin nr. 1, datë 29. 01.2009;
2. Kodi i Etikës për punonjësit e OST SHA, me nr.3952 prot., datë 01.07.2016;
3. Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurisë në ushtrimin e funksioneve publike me Nr. 8365 prot., dt 17.12.2019;
4. Urdhri i Brendshëm nr. 215, datë 19.09.2022 “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave”;
5. “Manuali Burimeve Njerëzore” me nr. 5824, datë 30.09.2022.

Struktura është e përshtatshme. Organigramat e miratuara me:

1. Vendimin Nr.9 datë 21/12/2021 “Për miratimin e strukturës organizative të aparatit qendror të OST sh.a.”;
2. Vendimin Nr.10 datë 21/12/2021 “Për miratimin e strukturës organizative të Njësisë Operative dhe Njësisë së Mirëmbajtje Transmetimit”.

Menaxhimi i riskut

Koordinatori i riskut është caktuar sipas strategjisë së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe strategjia e risqeve është caktuar me vendimin Nr. 91, datë 11.06.2018 të Asamblesë së Aksionarit për Miratimin e Strategjisë së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Shoqërisë “OST” SH.A Tiranë dhe me Nr. 10478/3 Prot, datë 11.06.2018.

Janë miratuar procedura për menaxhimin e riskut – për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të njësisë, të përcaktuara gjatë planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe vjetor:

- Strategjia e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në OST sh.a.
- Procedura e raportimit të ngjarjeve me risk operacional me nr.8435 prot., dt 20.12.2019.

Drejtuesit e të gjitha niveleve janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë që kanë në menaxhimin e riskut. Ata janë informuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, në mënyrë periodike me anë të strategjisë së MFK dhe procedurës së Raportimit të Ngjarjeve me Risk Operacional. Gjithashtu, ata janë

trajnuar periodikisht mbi menaxhimin e risqeve që ata mbulojnë, si dhe ju janë dërguar manuale dhe udhëzuesit përkatës.

Aktivitetet e kontrollit

NË lidhje me procedura te punës te shkruara, te paktën per proceset kryesore operationale dhe financiare, përfshirë dhe qarkullimin e dokumentacionit dhe të informacionit, hallkat e vendim-marrjes dhe kontrollet e brendshme të vendosura , janë të përfshirë në aktet si më poshtë:

- 1.“Detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në Aparatin Qendror të OST sh.a.(*rishikuar sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a., nr.9, datë 21.12.2021*) me nr. 978/1 prot, datë 11.02.2022;
- 2.“Detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në Njësitë Operative dhe Njësinë e Mirëmbajtje Transmetimit” (*e rishikuar*), me nr. 3329/2 prot., datë 28.05.2021.
- 3.Rregullore e dokumentimit ruajtjes, qarkullimit të aktiveve dhe nxjerrjes nga përdorimi në OST SHA., me nr 3736 prot., dt 21.05.2018;
- 4.Rregullore mbi mënyrën e funksionimit dhe përdorimit të automjeteve të OST SHA Nr.2514 prot., dt 20.04.2022;
- 5.Udhëzim për pajisjen e punonjësve me veshje pune e mjete mbrojtëse me nr. 2919/1 prot., dt 29.05.2020.

Aktivitet afatgjata dhe aktivitet e vlefshme per shoqërinë (përfshirë edhe të dhënat personale), të mbrojtura kundrejt aksesit dhe përdorimit të paautorizuar sipas përcaktimeve të “Rregullore e dokumentimit ruajtjes, qarkullimit të aktiveve dhe nxjerrjes nga përdorimi në OST SHA”, me nr 3736 prot., dt 21.05.2018.

Informimi dhe komunikimi

OST ka në përdorim sistemin office 365. Ky sistem ka të inkorporuar module për të bërë të mundur, menaxhimin e projekteve, detyrave dhe objektivave, në tërësi dhe në mënyrë të veçantë sipas rastit. Gjithashtu ka dhe sistem për menaxhimin e shkresave (DMS), praktikave dhe dokumentave në mënyrë elektronike. Ka urdhër të brendshëm për përdorimin e email dhe “Politika për përdorimin e postës elektronik”. Gjithashtu ka sisteme të tjera si ai i DMS (dokument management system).

OST ka ngritur mjete dhe sistemeve te shumëfishta për të bërë të mundur, komunikimin dhe raportimet e problemeve të mundshme. Disa sisteme monitorimi janë automatike dhe raportojnë me email. Ndërkohë sisteme të tjera në operim janë disa, si intranet, sistem për raportimet e defekteve, etj

Monitorimi

Një nga format e raportimit periodik është dërgimi i raporteve javore mujore/vjetore/ të cilat janë të dokumentuara.

Po kështu, bëhen raportime të vecanta me frekuencë dhe mënyrë të caktuar në varësi të çështjeve dhe/ose problematikave të aktivitetit të strukturave të shoqërisë. Ky monitorim në praktikë realizohet nëpërmjet analizave vjetore të punës të çdo Drejtorie mbi bazën e së cilës përgatitet analiza vjetore e shoqërisë.

Këshilli Mbikëqyrës informohet nga shoqëria nëpërmjet raportimit të aktivitetit të OST SHA, për periudha 3-6 mujore si dhe nëpërmjet kërkesave për miratime të ndryshme në përputhje me kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës të përcaktuar në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Statutin e shoqërisë, Udhëzimin Nr. 15, datë 2.5.2018 “Mbi programet e

zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të cilat referojnë tek detyrimi i marrjes së miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës, për çështje të caktuara.

II.2.9 Mbi hartimin, shqyrtimin, zbatimin dhe raportimin e programit ekonomik-financiar

Në zbatim të pikës të Programit të Auditimit nr. 222/1 Prot., datë 16.03.2023, Pika 2 “Mbi hartimin, shqyrtimin, zbatimin dhe raportimin e programit ekonomik-financiar” u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST):

Dokumentacioni i dërguar për mbledhjen e të dhënave.

Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e programeve ekonomike.

Dokumente të tjera.

Operatori i Sistemit të Transmetimit, Këshilli Mbikëqyrës, me anë të Vendimit nr. 1, datë 31.01.2022, vendosi për miratimin e programit të zhvillimit ekonomik të OST sh.a., për vitin 2022, sipas treguesve kryesorë të këtij programit:

1	Të ardhura gjithsej	Mijë/lekë	7,274,839
2	Shpenzime gjithsej	-	11,159,962
	<i>Nga këto për telefon celular</i>	-	5000
	<i>Shpenzime për sponsorizim</i>	-	6500
3	Fitim / Humbja bruto	-	-3,885,123
4	Fitim / Humbja neto	-	-3,885,123
	<i>Për shpërndarje e fitimit neto propozojmë</i>	-	-
	<i>Rezervë e domosdoshme (5%)</i>	-	-
	<i>Dividenti (10%)</i>	-	-
	<i>Për investime (85%)</i>	-	-
5	Fondi i pagave	Mijë/lekë	797,500
6	Numri mesatar i punonjësve	Nr.	806
7	Paga mesatare	Lekë	82,455
8	Investime gjithsej	Mijë/lekë	6,868,238
8.1	<i>Investime nga burimet e veta të shoqërisë (investime + kosto lokale)</i>	-	3,085,042
8.2	<i>Investime me financime të huaja</i>	-	3,783,196

Këshilli Mbikëqyrës i përbërë nga, znj. V. V. (Kryetare), znj. V. H., z. G. S., z. K. M., zj. S. H. dhe zj. V. J. (anëtarë).

Me anë të shkresës nr. 632 Prot., datë 31.01.2022, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkohet miratimi i Programit të Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a., për vitin 2022.

MFE me anë të një shkresë nr. 2092/1 dt. 23.03.2022 kërkon rishikimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik për vitin 2022 në lidhje me zërin shpenzime personeli ku përveç fondit për paga prej 797 milion lekë, OST sh.a. ka kërkuar

Pagesa për turne dhe orë jashtë orari në vlerën	46	Milionë lekë
Shpenzime ushqimi për punonjësit	93	Milionë lekë
Udhëtime dhe dieta	31	Milionë lekë
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	158	Milionë lekë

Shpenzime page për vjetërsinë në punë	89	Milionë lekë
Fondi suplementar i pensionit	39	Milionë lekë
Shpenzime të tjera personeli	44	Milionë lekë
Paga e 13	75	Milionë lekë

MFE kërkon që paga e 13 të zbriten nga zëri “shpenzime personeli” si dhe i kërkon të jepen sqarime në lidhje me shpenzimet e tjera, se çfarë përfshijnë.

Gjithashtu kanë kërkuar “shpenzime dhe shërbime ndihmëse” nga 215 milionë lekë në vitin 2021, në 1,708 milion lekë në vitin 2022.

Gjithashtu MFE me anë të shkresës nr. 5354 Prot., datë 23.03.2022 urdhëron që të gjitha Shoqëritë Aksionare të reduktojnë shpenzimet me karburant në masën 50% të planifikimi të tyre.

Në lidhje me dy shkresat e mësipërme është kthyer përgjigje nga ana e OST sh.a. me shkresën nr. 2132 prot., datë 04.04.2022 duke dhënë argumentimin për sa më sipër por duke mos i ndryshuar ato, gjithashtu kërkon nga ana e buxhetit të shtetit mbulimin me fonde në vlerën 58 milionë Euro, përkatësisht 21 Milionë euro për vitin 2022 dhe 37 milionë Euro për vitin 2023.

Lidhur me miratimin e programit ekonomik, me anë të shkresës nr. 2092/2 datë 20.05.2022 është miratuar dhe nga ana e MFE.

Gjithashtu përsa i përket programit ekonomik, janë dhe dy ndryshime të miratuara nga ana e Këshillit Mbikëqyrës me anë të shkresave nr. 4287 Prot., datë 07.07.2022 si dhe shkresën nr. 54611 prot., datë 09.09.2022.

Në lidhje me zërin shpenzime të tjera personeli përfshihen:

Pagesa për antidota

Shpërblime për ndryshim strukture

Shpenzime mjekësore të aksidenteve në punë

Shpenzime për pagesë largimi nga puna

Shpenzime për lindje fëmije

Shpenzime për dalje në pension

Shpenzime për sëmundje të zgjatura

Shpenzime për rast vdekjeje

Shpërblim për leje vjetore të pakryer

Shpenzime për shpërblime specifike

Analiza e të ardhurave

Të ardhurat totale për Vitin 2022, kanë rezultuar te jenë 12,557 milionë lekë nga 8,981 milionë lekë që ishin parashikuar në programin e zhvillimit të vitit 2022. Realizimi i tyre është në masën 140%.

Të ardhurat operative për Vitin 2022, kanë rezultuar te jenë 10,986 milionë lekë nga 8,981 milionë lekë që ishin parashikuar në programin e zhvillimit të vitit 2022. Realizimi i tyre është në masën 122%.

Rreth 48% të të ardhurave operative, e zënë të ardhurat nga transmetimi i energjisë elektrike tek OSHEE Group sh.a.. Këto të ardhura janë realizuar në masën 99%.

Të ardhurat nga Transmetimi i Energjisë

Duke filluar nga data 1 Maj 2022 deri me 31 Dhjetor 2022, është aplikuar tarifa e transmetimit 0.85 lekë/kËh nga 0.75 lekë/kËh që ishte deri në atë periudhë.

Me vendimin Nr. 72, datë 13.04.2022 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022-2024”, Enti Rregullator i Energjisë, ka miratuar tarifën mesatare të transmetimit në masën 0.85 lekë/kËh për periudhën rregullatore 1 maj 2022 - 31 dhjetor 2024.

Të ardhurat nga transmetimi i energjisë për Vitin 2022, janë realizuar në masën 93%.

Të ardhurat nga transmetimi për OSHEE sh.a. janë realizuar në masën 99%.

Të ardhurat e transmetimit nga shoqëritë e liçensuara nga ERE në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar janë realizuar në masën 60% në krahasim me planin. Kjo diferencë, ka ardhur si rezultat i sasisë më të vogël të energjisë së furnizuar, sipas kërkesës së këtyre të fundit

Në mënyrë të detajuar, të ardhurat e realizuara për transmetimin e energjisë elektrike gjatë vitit 2022, të shprehura në lekë, tregohen si më poshtë:

Klientët	Të Ardhurat (lekë)
OSHEE Group	5,303,330,774
KESH	5,734,051
Furnizuesit e Kualifikuar	564,964,603
Tranzitim Energjie	8,256,707

Të ardhurat nga Alokimi i Kapaciteteve

Të ardhurat nga alokimi i kapaciteteve janë realizuar në masën 133% në krahasim me planin.

Të ardhura nga grantet

Të ardhurat nga Grantet janë realizuar në vlerën 63 milionë leke, nga 50 milionë që ishte parashikuar në programin e vitit 2022, pra në masën 126%.

Të ardhura nga tregu i balancimit


Në Vitin 2022, në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të OST sh.a., aktiviteti i tregut të balancimit ka rezultuar në një vlerë neto rreth 2,993 milionë lekë si e ardhur.

Në mënyrë të detajuar, disbalancat gjatë vitit 2022, të shprehura në lekë, tregohen si më poshtë:

Muaji	Te ardhura	Shpenzime	Neto
Janar	514,117,460	250,274,046	263,843,413
Shkurt	499,384,581	200,347,846	299,036,735
Mars	785,217,877	504,554,703	280,663,174
Prill	804,756,027	518,502,106	286,253,921
Maj	943,638,063	761,528,373	182,109,690
Qershor	721,275,666	516,320,899	204,954,767
Korrik	477,427,587	722,081,467	-244,653,880
Gusht	632,330,964	530,244,411	102,086,553
Shtator	1,169,630,763	202,589,741	967,041,022
Tetor	1,186,995,471	952,290,140	234,705,331
Nëntor	819,938,104	593,417,073	226,521,031

Dhjetor	893,041,529	702,700,602	190,340,927
TOTALI	9,447,754,092	6,454,851,409	2,992,902,683

Në grafikun e mëposhtëm, paraqiten vlera neto në lekë e aktivitetit të tregut të balancimit për secilën palë përgjegjëse, gjatë Vitit 2022:



Të ardhura nga telekomunikacioni

Të ardhurat nga telekomunikacioni janë realizuar në vlerën 39.1 milionë lekë, nga 50 milionë lekë që ishte parashikuar në programin e vitit 2022, pra në masën prej 78%.

Të ardhura të tjera dhe financiare

Zëri të ardhura të tjera përfshin të ardhurat nga lidhjet e reja, tarifat e mbikëqyrjes, penalitete dhe gjoba, si dhe të gjitha të ardhurat që realizojnë Njësitë Operative. Ky zë është realizuar në vlerën 56.2 milionë lekë. Gjatë Vitit 2022, të ardhurat financiare kanë rezultuar në vlerën 1,570 milionë lekë. Këto të ardhura janë kryesisht për efekt të kurseve të këmbimit

Analiza e Shpenzimeve

Shpenzimet Operative për Vitin 2022, kanë rezultuar të jenë 11,041 milionë lekë nga 10,245 milionë lekë që ishin parashikuar në programin e zhvillimit të vitit 2022. Një vlerë prej 2,826 milionë leke përbëhet nga përlllogaritja e provizioneve (2,596 mln lekë) dhe gjoba e dëmshpërblime (230 mln lekë), shpenzime këto të cilat nuk ishin parashikuar më pare.

Realizimi i tyre është në masën 108%.

Shpenzimet Totale për Vitin 2022, kanë rezultuar të jenë 11,678 milionë lekë nga 10,861 milionë lekë që ishin parashikuar në programin e zhvillimit të vitit 2022.

Realizimi i tyre është në masën 108%.

Shpenzimet për personelin

Shpenzimet e planifikuara dhe të shpërndara përgjatë vitit 2022 kanë qenë 1,373 milion lekë, ndërsa realizimi i tyre është 1,247 milion lekë, ose në masën 91%.

Në mënyrë të detajuar, realizimi i zërave të shpenzimeve për personelin jepen si më poshtë:

Zëri	Njësia e matjes	Viti 2021		
		Plan	Fakt	%
Fond per Pagat	mln ALL	797.5	758.0	95%
Shtesa turni & Ore jashte orarit	"	48.9	49.1	100%
Ushqim Ditor	"	93.1	87.4	94%
Udhetim dhe Dieta	"	34.3	20.53	60%
Sigurime Shoqerore	"	158.3	158.4	100%
Vjetersia ne Pune	"	92.9	88.8	96%
Pensioni Vullnetar	"	43.1	42.7	99%
Shpenzime te tjera Personeli	"	34.6	23.2	67%
Shperblime	"	70.0	19.1	27%
Totali	"	1,372.6	1,247.4	91%
Nr. mesatar i punonjësve	Nr	806	779	96.7%
Paga mesatare	ALL	82,458	81,084	98.3%

Shpenzimet për blerje materiale

Shpenzimet materiale për Vitin 2022 u realizuan në vlerën 116.0 milionë lekë nga 132.0 milionë lekë të parashikuara ose 88% në krahasim me planin.

Shpenzimet për furnitura dhe shërbime

Shpenzimet për furnitura dhe shërbime për Vitin 2021 u realizuan në vlerën 513 milionë lekë nga 523 milionë lekë të parashikuara ose 98% në krahasim me planin.

Shpenzime mirëmbajtjeje dhe riparime

Shpenzimet për mirëmbajtje dhe riparime përfshijnë shpenzimet për mirëmbajtjen e automjeteve të administratës dhe njësive operative të OST sh.a. dhe shpenzimet e ndryshme të mirëmbajtjes për ambientet e administratës qendrore dhe ambientet e gjelbërta, mirëmbajtje e impianteve të godinës së OST sh.a., mirëmbajtjen e sistemeve dhe platformave, etj.

Në mënyrë të detajuar, realizimi i shpenzimeve për mirëmbajtje dhe riparime jepen si më poshtë:

Mirëmbajtje dhe Riparime		
Sherbim Platforme ENTSOE	ALL	34,601,461
Mirembajtja e automjeteve	ALL	33,472,366
Mirembajtje e sistemit qendror SCADA/EMS	ALL	22,635,447
Mirembajtje Pajisjeve ABB_PL/MPLS-TP/SDH	ALL	15,269,833
Sherbimi i mirembajtjes DEDM	ALL	14,572,917
Mirembajtje, riparime Njesite Operative	ALL	9,711,203
Sherbimi i mirembajtjes te sistemeve ne cloud	ALL	7,288,900
Platforma DAMAS	ALL	4,726,485
Mirembajtje e ambjenteve te jashtme te zyrave qendrore	ALL	3,250,158
Mirembajtja e godines dhe sistemeve te saj	ALL	1,854,166
Mirembajtje e Platformes Online	ALL	1,700,000

Mirembajtje/suport i licencave	ALL	1,560,850
Mirembajtje sistemi kunder zjarrit	ALL	753,900
Mirembajtja e sistemit GPS te Automjeteve	ALL	633,333
Pjese rezerve per pajisje	ALL	151,400

Shpenzime të tjera

Në mënyrë të detajuar, realizimi i shpenzimeve të tjera jepen si më poshtë:

Shpenzime te tjera		
Gjoha dhe dëmshpërblime	ALL	229,765,530
Ruajtja e Objekteve	ALL	127,168,291
Shpenzime per daljen jashte perdorimit te mjeteve kryesore	ALL	118,153,737
Kërkime dhe studime	ALL	40,565,505
Shpenzime për konçesione, patenta, liçensa dhe të ngjashme	ALL	18,522,725
Sigurime	ALL	14,592,295
Të tjera	ALL	13,399,122
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	ALL	11,663,662
Sherbime Teknike	ALL	4,332,537
Trainime per personel	ALL	3,974,475
Qira	ALL	3,262,032
Keshilli Mbikqyres	ALL	2,451,759
Shpenzime për shërbimet bankare	ALL	1,563,613
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	ALL	895,446
Publicitet, reklama	ALL	264,993

Blerja e shërbimeve ndihmëse

Shpenzimet për shërbimet ndihmëse të OST sh.a., u realizuan në vlerën 535 milionë, ose 56% e planit.

Blerja e Humbjeve

Shpenzimet për humbjet, u realizuan në vlerën 3,115.5 milionë lekë nga 4,196.0 milionë lekë të parashikuara, ose 74%.

Në reduktimin e këtyre kostove, kryesisht ka ndikuar efektet e VKM nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i cili parashikon sigurimin e humbjeve të energjisë elektrike në transmetim nga ana ana e KESH sh.a. me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike, çmim i cili për vitin 2022 sipas Vendimit të ERE Nr. 253, datë 21.12.2021 është 8.5652 lekë/kWh.

Vlera prej 1,080 mln lekë më e ulët se plani vjen si rezultat i efekteve të pasqyruar në grafikun e mëposhtëm:

974 mln lekë më pak, si efekt i çmimit më të ulët të rezultuar në krahasim me planin për vitin 2022; 106 mln lekë më pak, si efekt i sasisë më të vogël të humbjeve të rezultuar në krahasim me planin për vitin 2022.

Në grafikun e mëposhtëm, paraqitet vlera në lekë e humbjeve sipas furnizuesve, për Vitin 2022

Pagesat ITC

Gjatë Vitit 2022, shpenzimet për ITC, kanë rezultuar rreth 230.8 milionë lekë nga 250 milionë lekë të parashikuara.

Shpenzimet për Organizma Rajonal

Shpenzimet për pjesëmarrjen në organizmat rajonale, u realizuan në vlerën 98.8 milionë lekë nga 105 milionë lekë të parashikuara, ose 94%.

Nr	Pagesa per organizmat Rajonale	Vlera Leke
1	ENTSOE	52,532,823
2	ERE	18,420,941
3	SCC LTD Beograd	17,803,000
4	SEE CAO	8,770,969
5	Med TSO	1,218,800
6	KNC Kosove	70,441

Shpenzime për ekspertë kontabël dhe vlerësim

Shpenzimet për ekspertë kontabël dhe vlerësues, u realizuan në vlerën 44.1 milionë lekë nga 20 milionë lekë të parashikuara

Gjate vitit 2022 në zbatim të Vendimit të Asamblesë së Aksionarit nr. 99 datë 15/09/2022 “Për rivlerësimin e asetëve të shoqërisë OST sh.a”, më datë 08.11.2022, OST sh.a. ka lidhur kontratën me objekt “Për rivlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale të OST sh.a sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit”. Lidhja e kontratës dhe kushtet e pagesës në këtë kontratë, kanë ndikuar në rritjen e këtij zëri të shpenzimeve.

Shpenzime për taksat

Shpenzimet për taksat, u realizuan në vlerën 6.5 milionë lekë

Shpenzime për amortizimin

Shpenzimet për amortizimin, u realizuan në vlerën 2,253.3 milionë lekë.

Shpenzime për Humbjen nga rënia në vlerë e asetëve, Gjoha dhe dëmshpërblime, Shpenzime Financiare

Referuar Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe konkretisht SNK 36 “Zhvlerësimi i Aktive”, grupi i Ekspertëve Vlerësues dhe Audituesve Ligjorë të përcaktuar me vendimin e cituar në pikën b.8, pas nje analize të detajuar ka kryer testin e zhvlerësimit të aktiveve fikse me 31 dhjetor 2022.

Qëllimi i testit të zhvlerësimit është të sigurojë që Aktivet në pronësi të Shoqërisë, janë regjistruar në pasqyrat financiare në një shumë që nuk tejkalon vlerën e tyre të rikuperueshme.

Me shkresën nr. 3898/1 prot. datë 28/03/2023, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është vendosur përfshirja e efekteve të Testit të Zhvlerësimit të Aktiveve Afatgjata Materiale të OST sh.a. në Pasqyrat Financiare të vitit 2022.

Rezultati i testit të zhvlerësimit i përfshirë në pasqyrën e Të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2022 është 2,596.7 milionë lekë.

Vlera e gjoha dëmshpërblime për vitin 2022, ka rezultuar 229.8 milionë lekë. Shpenzimet për interesa për vitin 2022, kanë rezultuar te jene 447.5 milionë lekë nga 616 milionë lekë që ishin parashikuar në programin e zhvillimit të vitit 2021 ose 73%.

Rezultati financiar (Fitimi/Humbja neto)

Viti 2022, ka rezultuar me një Fitim Neto, në vlerën 937.4 milionë lekë

Për sa më sipër u konstatua:

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për Vitin 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në milionë lekë

Të ardhurat (mln ALL)	Viti 2022			Shënim
	Plan	Fakt	Realizimi	
Furnizuesit e kualifikuar	956.5	570.7	60%	X
OSHEE sh.a.	5,335.1	5,303.3	99%	
Tranzit Energjie	0.0	8.3		
Te ardhura nga Transmetimi	6,291.6	5,882.3	93%	
Alokimi i kapaciteteve	1,380.0	1,829.6	133%	Y
Te ardhura nga tregu i balancimit	1,204.4	2,992.9		
Te ardhura nga telekomunikacioni	50.0	39.1	78%	X
Të ardhura nga Grantet	50.0	62.9	126%	Y
Rimarje provizini		123.3		
Të ardhura te tjera	5.0	56.2	1125%	
Total të ardhura Operative	8,981.0	10,986.3	122%	Y
Total të ardhura Financiare	0.0	1,570.4		
TOTAL TE ARDHURA	8,981.0	12,556.7	140%	Y
Shpenzimet (mln ALL)	Plan	Fakt	Realizimi	
Personeli	1,372.6	1,247.4	91%	
Materiale të para	132.0	116.0	88%	
Furniturat dhe Shërbimet	522.7	513.0	98%	
Blerja e shërbimeve ndihmese	955.1	534.9	56%	X
Blerja e humbjeve	4,196.0	3,115.5	74%	X
Pagesë ITC	250.0	230.8	92%	
Pagesë për organizmat rajonale e europiane	105.0	98.8	94%	
Shpenzime per eksperte kontabel dhe vleresues	20.0	44.1	221%	Y
Pagesa për Ndermarrjet, Vendim Asambleje		54.5		
Taksa	5.5	6.5	118%	Y
Gjoha dhe demshperblime		229.8		
Humbje nga renia ne vlere e aseteve	0.0	2,596.7		
Amortizimi	2,686.2	2,253.3	84%	
Total shpenzime Operative	10,245.1	11,041.3	108%	
Rezultati Operativ	-1,264.1	-55.0	4%	
Shpenzime për interesa	616.0	447.5	73%	X
Humbje nga kurset e këmbimit dhe te tjera		188.7		
Total shpenzime Financiare	616.0	636.2	103%	
TOTAL SHPENZIME	10,861.1	11,677.5	108%	
Fitimi para tatimit	-1,880.0	879.2		
Tatim fitimi	0.0	-58.2		
Fitimi NETO	-1,880.0	937.4		

- Bazuar në tabelën e mësipërme, në seksionin shënime, janë vënë në dukje të ardhurat dhe shpenzimet, mbi të cilat planifikimi i tyre nuk ka qene i saktë, dhe devijanca e tyre në lidhje me realizimin është e lartë.
- Shpenzimet janë rritur ndërkohë që të ardhurat janë pakësuar.
- Në lidhje me zërin “Shpenzime mjekësore të aksidenteve në punë”, nuk bëhet e qartë se cilat janë zërat që mbulohen dhe nëse lidhen me procedurat mbi sigurimin privat të punonjësve të punës në terren.
- OST, ka programuar zëra shpenzimesh të cilët nuk i shërbejnë qëllimit dhe natyrës së aktivitetit të punës, mungon lidhja e objektivave dhe qëllimit të tyre me produktin konkret të projektit dhe programit buxhetor, si edhe një analizë e detajuar prioritarizmi duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara, duke cënuar kështu përdorimin me efikasitet, efektivitet dhe produktivitet të fondeve në dispozicion të institucionit, si më poshtë:
 - Shpërblime për ndryshim strukture

- Shpenzime për pagesë largimi nga puna
 - Shpenzime për dalje në pension
- Shpenzimet për ekspertë kontabël dhe vlerësues, u realizuan në vlerën 44.1 milionë lekë nga 20 milionë lekë të parashikuara, duke kaluar fondit e parashikuar me gati 2 herë të parashikimit.

19. Titulli i Gjetjes:	Të ardhura dhe shpenzime, mbi të cilat planifikimi i tyre nuk ka qenë i saktë.
Situata:	<p>Bazuar në tabelën e mësipërme, në seksionin shënime, janë vënë në dukje të ardhurat dhe shpenzimet, mbi të cilat planifikimi i tyre nuk ka qenë i saktë, dhe devijanca e tyre në lidhje me realizimin është e lartë. Shpenzimet janë rritur ndërkohë që të ardhurat janë pakësuar.</p> <p>OST, ka programuar zëra shpenzimesh të cilët nuk i shërbejnë qëllimit dhe natyrës së aktivitetit të punës, mungon lidhja e objektivave dhe qëllimit të tyre me produktin konkret të projektit dhe programit buxhetor, si edhe një analizë e detajuar prioritarizmi duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara, duke cënuar kështu përdorimin me efikasitet, efektivitet dhe produktivitet të fondeve në dispozicion të institucionit, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> · Shpërblime për ndryshim strukture · Shpenzime për pagesë largimi nga puna · Shpenzime për dalje në pension <p>Shpenzimet për ekspertë kontabël dhe vlerësues, u realizuan në vlerën 44.1 milionë lekë nga 20 milionë lekë të parashikuara, duke kaluar fondit e parashikuar me gati 2 herë të parashikimit.</p>
Kriteri:	Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Mospërmbushje e objektivave të shoqërisë.
Shkaku:	Planifikim dhe menaxhim jo i saktë i buxhetit të shoqërisë
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandim:	OST sh.a., në të ardhmen, gjatë hartimit të buxheteve, të analizojë me kujdes situatën e shoqërisë, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e tyre, negocimin e kushteve më të mira si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive. Të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi si dhe të kryejë një planifikim të saktë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke u bazuar dhe në vitet e mëparshme.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi
 Këshilli Mbikëqyrës i OST,
 z. S. D., në cilësinë e Administratorit të shoqërisë dhe
 z. A. K., në cilësinë e Drejtorit Ekonomik

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Operatorin e Sistemit të Transmetimit administruar në KLSH me nr. 1188/6 prot., datë 07.08.2019, janë rekomanduar gjithsej:

- 27 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 8 masa, në proces zbatimi 18 masa dhe të pa zbatuara 1 masë;

- 5 masa shpërblim dëmi, nga të cilat janë zbatuar 4 masa, në proces zbatimi 1 masë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 5-8 , të Raportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes së shoqërisë, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimit që rezultoi i pa zbatuar, nxjerrjen e përgjegjësive dhe shkakut se përse nuk është zbatuar si dhe përshejtimin e atyre në proces zbatimi.

Në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të pikës 4 të Programit të Auditimit “Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve”, në lidhje me rekrutimin e punonjësve të rinj, nuk janë ndjekur procedurat e përcaktuara në Manualin e Burimeve Njerëzore. Deri në përzgjedhjen e tyre nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura; nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar hapat që ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj. Gjithashtu nuk u evidentua ndonjë gjurmë që sektorëve/departamenteve përkatëse ju ka lindur nevoja për rekrutimin e punonjësve të rinj. Gjatë auditimit të dosjeve të personelit dhe të dokumentit mbi “Detyrat funksionale dhe Kriteret e punësimit për pozicionet e punës”, përzgjedhja e punonjësve nuk është bërë në çdo rast në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj;. Për sa më sipër është vepruar jo në përputhje me Manualin e Burimeve njerëzore nr. 7862 Prot., datë 27.12.2016, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 12-18 , të Raportit të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: OST sh.a., gjatë hartimit të strukturës organizative të aparatit qendror OST sh.a. dhe njësisë të vartësisë, dhe në momentin e plotësimit të strukturës me punonjës të rinj, të marrë në konsideratë nevojat e sektorëve/departamenteve dhe njësisë të vartësisë, kriteret e vendosura dhe të miratuara nga Këshillimi Mbikëqyrës si dhe në Manualin e Burimeve Njerëzore si dhe të kryejë procedurat sipas metodave më të mira dhe me të drejta, për zhvillimin e tyre me transparencë të plotë dhe konkurrencë të plotë, duke përzgjedhur kandidatin e duhur sipas nevojave të institucionit. që të arrijnë eficiencën e plotë me qasjen me burimet njerëzore të duhura sipas nevojave.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të Pasqyrave Financiare, në vlerësimin e aseteve, vihet re që OST sh.a. nuk i ka regjistruar të gjitha pronat në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Ndërtimet në proces përfaqësojnë ndërtimin e aktiveve të transmetimit, duke përfshirë kryesisht linja transmetimi dhe nënstacione. Për sa më sipër është vepruar jo në përputhje me SNK 16 Aktivitet Afatgjatë Materiale. Njohja e aktiveve afatgjatë materiale behet me vlerën e drejte në mënyrë periodike çdo 5 vjet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 18-22 , të Raportit të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: OST, të bëjë të mundur ndjekjen dhe finalizimin e të gjitha procedurave në lidhje me regjistrimin e pronave në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

Menjëherë

4. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të pasqyrave financiare vihet re që në zërin Hua për palët e treta që lidhet me huan e dhënë për Albgaz sh.a me vendimin nr. 22, datë 13 qershor 2017, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a. Afati i maturimit të kredisë është dy vite. Sipas marrëveshjes mes OST dhe Albgaz Sh.a. huamarrësi ka për detyre kthimin e shumës së plote të huas me norme interesi 0 (zero) tek huadhënësi brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje. Me datë 22/10/2019 është firmos Amendimi Nr.1 i marrëveshjes së mësipërme sipas të cilit Huamarrësi ka për detyrim kthimin e shumës së plote të huas tek Huadhënësi me norme interesi zero brenda tre viteve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes si dhe dy amendimeve të tjera të cilat nuk janë të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës. Për sa më sipër është vepruar jo në përputhje me Vendimin nr. 22, datë 13 qershor 2017, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 18-22 , të Raportit të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: OST sh.a., të marrë të gjitha masat mbi kthimin e shumës së plotë të huas nga Albgaz sh.a., duke iu përmbajtur kushteve të kontratës, dhe në rast të moskthimit të shumës nga ana e tyre të marrë masat mbi vendosjen e kamatëvonesave ose penalizimeve sipas kushteve të kontratës.

Menjëherë

5. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të pasqyrave financiare vihet re një rritje në riskun mbi likuiditetin që përcaktohet si risku që njësi të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. OST është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndodhura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer kreditë. Nga ana tjetër, shoqëria përballet me vonesa të konsiderueshme në arkëtimet e shitjeve që i ka bërë OSHEE Sh.a. për shërbimin e transmetimit të energjisë. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 18-22 , të Raportit të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: OST sh.a., të marrë të gjitha masat mbi arkëtimin e shitjeve që i ka bërë OSHEE sh.a. për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike si dhe në rast të vonesave mbi arkëtimin e tyre të marrë masat mbi vendosjen e kamatëvonesave duke iu përmbajtur kushteve të kontratës.

Menjëherë

5. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të pasqyrave financiare vihet re një rritje në riskun mbi likuiditetin që përcaktohet si risku që njësi të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. OST është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndodhura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer kreditë. Nga ana tjetër, shoqëria përballet me vonesa të konsiderueshme në arkëtimet e shitjeve që i ka bërë OSHEE Sh.a. për shërbimin e transmetimit të energjisë. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 18-22 , të Raportit të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: OST sh.a., të marrë të gjitha masat mbi arkëtimin e shitjeve që i ka bërë OSHEE sh.a. për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike si dhe në rast të vonesave mbi arkëtimin e tyre të marrë masat mbi vendosjen e kamatëvonesave duke iu përmbajtur kushteve të kontratës.

6. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Rinovimi i suportit dhe licensave të platformës elektronike financiare, burimeve njerëzore, archive elektronike dhe sistemit të menaxhimit të dokumenteve”, nga verifikimi të dokumentacionit të ngarkuar në sistem nga ana e O.E. fitues, në lidhje me pikën 2.3.3 në Kriteret e Vecanta “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë suportin ose autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”, O.E. fitues ka paraqitur deklaratë nga Zyra e përfaqësisë O. në Shqipëri, O. N. B.V. Albania Representative Office. Nga hulumtimet e kryera nga grupi i auditimit në faqen zyrtare të kompanisë O., O.E. nuk rezulton të jetë partner i kompanisë Oracle, ashtu siç deklaroi. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë certifikimet si me poshtë: sisteme O. ERP, sisteme BI, infrastructure Cloud, sisteme ERP Cloud, sisteme për rrjetin e shpërndarjes (Supply Chain), Certifikata e lëshuar nga Tatimet dhe AKSHI si prodhues dhe për mirëmbajtjen e softuerike për fiskalizimin me dhe pa para në dore, faturën elektronike si dhe faturën shoqëruese (qe ofertohet). Periudha e vlefshmërisë së certifikimeve të mësipërme është deri më 29 Mars 2023, periudhë që nuk e mbulon të plotë shërbimin 1 vjeçare të Rinovimit të suportit dhe licensave. Për sa më sipër është vepruar jo në përputhje me Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 22-45 , të Raportit të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: OST, në rastin e vlerësimit të ofertave të kryhet vlerësim i drejtë dhe transparent duke u bazuar në bazën ligjore dhe udhëzimet përkatëse si dhe duke i dhënë gjithmonë përparësi ofertave më të ulëta në rast se përmbushin dokumentacionin e plotë të kërkuar dhe në rastin kur oferta është e dyshimtë mbi përmbushjen e disa kriterëve ose specifikimeve, të kërkohet informacion më tepër në lidhje me të, deri në sqarim e plotë të rastit.

Në vijimësi

7. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Shërbimi privat i sigurisë fizike”, në vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit ngarkuar në sistem nga O.E. fitues të procedurës u konstatua që në dokumentacionin e sjellë nuk citohet se cilët do jenë punonjësit me të cilët do të realizohet shërbimi, por janë mjaftuar me certifikatat për punonjës shërbimi, ku për të cilët janë sjellë në tërësi të gjitha certifikatat e lëshuara për të gjithë punonjësit e O.E.. Lista e punonjësve do të bënte të mundur dhe verifikimin nëse këto punonjës nuk janë angazhuar në kontrata të tjera të lidhura nga O.E. Gjithashtu nuk është kërkuar një listëpagesë e punonjësve e shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe një deklaratë bankare, pasi nga O.E. deklarohet që pagesa për punonjësit është në vlerën 66,359.88 lekë/roje/muaj. Për sa më sipër në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 22-45 , të Raportit të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: OST sh.a., gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të marrë në konsideratë të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të detajuara të nevojshme si dhe gjatë vlerësimit të ofertave të bëjë testet dhe verifikimet përkatëse me çdo institucion tjetër në lidhje me deklaratat e lëshuara nga O.E. pjesëmarrës.

Menjëherë

8. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Suport, licenca dhe mirëmbajtje për pajisjet Hardw̄are”, në hartimin e kriterëve të veçanta janë përfshirë në kriterin 2.3.4 Përdorimi i termit në këtë rast certifikuar nga prodhuesi kufizojnë konkurrencën dhe nuk janë në përputhje me objektin e kontratës dhe vlerën e kontratës. Procedura e hapur e thjeshtuar nuk duhet të ketë shumë kritere, në mënyrë që të jetë e mundur përfshirja e biznesit të vogël dhe të mesëm në kundërshtim me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 22-45 , të Raportit të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: OST sh.a., gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të mirëmbajtjes së pajisjeve hard̄are, të krijojë kushte me gjithëpërfshirëse, pasi vendosja e kriterëve të cilët kërkojnë certifikime të prodhuesve pengojnë zhvillimin e një gare dhe konkurrence të drejtë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Suport, licenca dhe mirëmbajtje për pajisjet Hardw̄are”, në vlerësimin e ofertave vihet re që pika 2.3.3 e kriterëve të veçanta “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë suportin ose autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për pajisjet dhe platformat (S̄witche, NFḠË, platforme NAC, sistemi NMS, Akses Point, S̄witche Aksesit). Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, w̄eb site, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”, nuk përmbushet nga O.E. fitues, ku në dokumentet e ngarkuara nga O.E. në sistemin elektronik të APP, gjendej vetëm një autorizim nga Hewlett Packard me anë të e-mailit, ku dhe kjo e fundit nuk i mbulon të gjitha artikujt në specifikimet teknike në kundërshtim me Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 22-45 , të Raportit të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: OST sh.a., të tregojë kujdes gjatë vlerësimit të ofertave dhe të marrë në konsideratë të gjithë kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara nëse janë ose jo në përputhje me dokumentacionin e sjellë nga O.E. pjesëmarrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “FV lexues aksesit dhe sisteme të tjera për zonat e sigurisë së lartë në AQ dhe njësi”, në analizimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi vihet re kriteri nr. 2.3.5, sipas grupit të auditimit, duke u bazuar dhe tek vlera e kontratës, certifikimet e kërkuara janë të tepërta, pasi kufizojnë konkurrencën dhe nuk janë në përputhje me objektin e kontratës dhe vlerën e kontratës. Procedura e hapur e thjeshtuar nuk duhet të ketë shumë kritere, në mënyrë që të jetë e mundur përfshirja e biznesit të vogël dhe të mesëm në kundërshtim me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 22-45 , të Raportit të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: OST sh.a., gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të mirëmbajtjes, të krijojë kushte me gjithëpërfshirëse, pasi vendosja e kriterëve të cilët kërkojnë certifikimin e vetëm të prodhuesve do të pengojnë zhvillimin e një konkurrence të drejtë.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, disa nga procedurat e prokurimit janë zhvilluar muajin e fundit të vitit, që përbëjnë risk mbi mënyrën e përdorimit të fondeve si dhe disa nga procedurat e tjera të cilat kanë objekt të ngjashëm me njëra tjetrën por që janë zhvilluar të ndara, duke bërë të mundur copëzimin e fondit dhe jo përdorimin e procedurave të prokurimit me vlerë të lartë. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit nr. 05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” si dhe nenin 56, pika 2 dhe pika 11, e Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për Prokurimin publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 45-53 , të Raportit të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: AK të marrë masa për trajnimin e punonjësve që kryejnë procedurat e prokurimit, duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve të brendshme për menaxhimin e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

12. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të pikës së programit nr.9 “Mbi hartimin, shqyrtimin, zbatimin dhe raportimin e programit ekonomiko-financiar”, janë vënë në dukje të ardhurat dhe shpenzimet, mbi të cilat planifikimi i tyre nuk ka qene i saktë, dhe devijanca e tyre në lidhje me realizimin është e lartë. Shpenzimet janë rritur ndërkohë që të ardhurat janë pakësuar.

OST, ka programuar zëra shpenzimesh të cilët nuk i shërbejnë qëllimit dhe natyrës së aktivitetit të punës, mungon lidhja e objektivave dhe qëllimit të tyre me produktin konkret të projektit dhe programit buxhetor, si edhe një analizë e detajuar prioritarizmi duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara, duke cenuar kështu përdorimin me efikasitet, efektivitet dhe produktivitet të fondeve në dispozicion të institucionit, si më poshtë: Shpërblime për ndryshim strukture, shpenzime për pagesë largimi nga pune dhe shpenzime për dalje në pension.

Shpenzimet për ekspertë kontabël dhe vlerësues, u realizuan në vlerën 44.1 milionë lekë nga 20 milionë lekë të parashikuara, duke kaluar fondit e parashikuar me gati 2 herë të parashikimit. Për sa më sipër është vepruar jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 56-66 , të Raportit të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: OST sh.a., në të ardhmen, gjatë hartimit të buxheteve, të analizojë me kujdes situatën e shoqërisë, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e tyre, negocimin e kushteve më të mira si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive. Të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi si dhe të kryejë një planifikim të saktë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke u bazuar dhe në vitet e mëparshme.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit, u konstatua se nuk administrohet Oponenca Teknike e objekteve të ndërtimit “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë” dhe “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 22-45 , të Raportit të Auditimit)

13.1. Rekomandim: Titullari i OST sh.a. të marrë masa që të gjitha objektet që prokurohen si “punë publike”, të pajisen me oponencën teknike para fillimit të procedurës së prokurimit, me qëllim që të jenë konform standardeve të projektimit, për të përfituar objekte cilësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit, u konstatua se kolaudimi i objekteve “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë” dhe “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”, është kryer nga stafi teknik i OST sh.a., të cilët nuk janë të pajisur me licencën profesionale për kolaudimin e objekteve, në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 12.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 22-45 , të Raportit të Auditimit)

14.1. Rekomandim: Titullari i OST sh.a. të marrë masa që për të gjitha objektet që zbatohen në OST, të ngrihen grupe kolaudimi me specialistë të licencuar profesionalisht, me qëllim kontrollin cilësor të punimeve të përfunduara. Në rast të mungesës së një stafi të licencuar në institucion, kolaudimi të kryhet nga shoqëri/individë me licencat përkatëse të kolaudimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i realizimit të punimeve në procedurën e prokurimit me objekt “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë”, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume në zërin e punës “Trajnim i inxhinierëve të SMR për parametrizimin dhe aksesimin e pajisjeve (sipas specifikimeve teknike)”, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Sa më sipër është në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1292/13 prot datë 12.04.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 968/14 prot datë 11.05.2021.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas Urdhrit të Administratorit të OST sh.a. me nr. 302, datë 15.11.2021.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 22-45 , të Raportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Nga OST sh.a. të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **802,400** lekë pa TVSh nga OE “G.A.C.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 968/14 prot datë 11.05.2021 me objekt “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i realizimit të punimeve në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Gërmim dheu me ekskavator 0.25 m3, tokë e zakonshme, kategoria III, për rrugët, t=20cm, me shkarkim në mjet”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 22-45 , të Raportit të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Nga OST sh.a. të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **237,600** lekë pa TVSh nga BOE “A & E” SHPK & “K...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1246 prot datë 27.04.2021 me objekt “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Automjete me qira operationale Leasing”, nga strukturat përgjegjëse të OST në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit, nuk është kryer një analizë kosto-përfitim në lidhje me automjetet e mësipërme, nëse do ishte menduar zhvillimi i procedurës për blerjen e tyre, duke analizuar përfitimin mbi përdorimin e tyre si dhe vlerën e mbetur pas 60 muajve (5 viteve), duke e cilësuar fondit prej 35,450,000 lekë si fond i përdorur pa 3E, në kundërshtim me Ligjin nr.10 296, Datë 8.7.2010 Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 22-45 , të Raportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: OST sh.a., në të ardhmen, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të kryejë një analizë kosto përfitim të tyre mbështetur në praktikat më të mira.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE:

E.1. Për punonjësit në marrëdhënie pune

E.1.2 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statute të parashikuara në ligje të veçanta

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; gerrat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, **i rekomandojmë Administratorit të Shoqërisë OST, Komisionit Disiplinor**, pranë Institucionit Tuaj, që bazuar në performancën e punonjësve dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

V. LISTA E DOKUMENTACIONIT TË AUDITIMIT

1. Akt Verifikim nr.1, datë 19.05.2023 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëmi KLSH-së”

2. Akt Verifikim nr.2, datë 19.05.2023 “Auditim me zgjedhje ne disa Njësi Operative të Transmetimit”

1. Akt Konstatim nr.1, datë 19.05.2023 *“Mbi hartimin, shqyrtimin, zbatimin dhe raportimin e programit ekonomiko-financiare”*
2. Akt konstatim nr. 2, datë 19.05.2023 *“Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese (Asambleja e Përgjithshme Këshili Mbikëqyrës dhe Administrator”*
3. Akt konstatim nr. 3, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 datë 16.03.2023 *“Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave”*
4. Akt konstatim nr. 4 datë 19.05.2023 *“Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve”*
5. Akt konstatim nr. 6 datë 19.05.2023 *“Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve”*
6. Akt konstatim nr. 14 datë 16.03.2023 *“Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlerë të vogël (shpenzimet administrative për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj...”*.

Shënim: Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë Raport Përfundimtar auditimi duhet t’u bëhet prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t’u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.